

PËRMIRËSIMI I SIGURISË SË GAZETARËVE PËRMES NDRYSHIMEVE NË KODIN PENAL – ANALIZA E STANDARDEVE NDËRKOMBËTARE DHE LEGJISLACIONIT VENDOR

Kostadin Bogdanov
Ivan Breshkovski
Dragan Sekullovski





PËRMIRËSIMI I SIGURISË SË GAZETARËVE PËRMES NDRYSHIMEVE NË KODIN PENAL – ANALIZA E STANDARDEVE NDËRKOMBËTARE DHE LEGJISLACIONIT VENDOR

Kostadin Bogdanov
Ivan Breshkovski
Dragan Sekullovski

Impresum

Titull:

Përmirësimi i sigurisë së gazetarëve përmes ndryshimeve në Kodin Penal
– Analiza e standardeve ndërkombëtare dhe legjislacionit vendor

Autorë:

Kostadin Bogdanov
Ivan Breshkovski
Dragan Sekullovski

Botues:

Fondacioni Konrad Adenauer në Republikën e Maqedonisë së Veriut
Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë

Koordinim:

Norbert Bekman-Dirkes
Davor Pashoski

Përktheu:

Deniz Sulejman

Përgatitje kompjuterike dhe shtypje:

Vinsent Grafika DOO Skopje

Tirazhi:

100 shembuj

Ky publikim mund të shkarkohet pa pagesë në:

<https://www.kas.de/mk/web/nordmazedonien>

<https://znm.org.mk/>

Paralajmërim:

Pikëpamjet e shprehura në këtë botim nuk mund të konsiderohet se pasqyrojnë qëndrimet e Fondacionit Konrad Adenauer dhe Shoqatës së Gazetarëve të Maqedonisë, por janë pikëpamje personale të autorëve.

Përmbajtje

HYRJE 5

Nevoja për një analizë të tillë5

AKTIVITETET E SHGM-SË PËR AKTUALIZIMIN E ÇËSHTJEVE LIDHUR ME SIGURINË E GAZETARËVE 7

MEKANIZMAT MULTILATERAL NDËRKOMBËTARË PËR MBROJTJEN E GAZETARËVE DHE LIRINË E SHPREHJES 10

Kombet e Bashkuara (KB)11

Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE)16

Bashkimi Evropian (BE)18

Këshilli i Evropës (KE).....19

PRAKTIKA E GJYKATËS EVROPIANE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT PËR MBROJTJEN E PROFESIONIT TË GAZETARISË DHE TË DREJTËN E LIRISË SË SHPREHJES 23

SHQYRTIM KRAHASUES I LIGJEVE PENALE/CIVILE TË FINLANDËS, FRANCËS DHE GJERMANISË NË LIDHJE ME DISPOZITAT PËR MBROJTJEN E GAZETARËVE NGA ASPEKTI I KËRCËNIMEVE DHE FRIKËSIMEVE TË KRYERA PËRMES RRJETEVE SOCIALE/INTERNETIT 26

Finlanda27

Franca30

Gjermania31

RAPORTE NDËRKOMBËTARE DHE OBLIGIMET E SHTETIT LIDHUR ME SIGURINË E GAZETARËVE DHE PUNONJËSVE MEDIATIK 33

LEGJISLACIONI NË VEND DHE PRAKTIKA **36**

Shqyrtim historik i ndryshimeve dhe plotësimeve të Kodit Penal në RMV36

Definimi39

Praktika e autoriteteve të prokurorisë40

PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME **43**

Hyrje

Nevoja për një analizë të tillë

Qëllimi i analizës është të ndihmojë gazetarët dhe punonjësit mediatik, gjyqtarët, prokurorët, avokatët dhe Ministrinë e Drejtësisë në zbatimin e standardeve ndërkombëtare për mbrojtjen e gazetarëve në Kodin Penal (KP) në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Më këtë analizë vazhdojnë përpjekjet e Shoqatës së Gazetarëve të Maqedonisë (SHGM) për të rritur ndërgjegjen e publikut për çështje që lidhen me sigurinë e gazetarëve dhe dëmet e mundshme nga praktika e vendosur e mosndëshkimit për kryesit e veprave penale kundër gazetarëve.

Analiza thekson rëndësinë e Kodit Penal si dhe Ligjit për Procedurën Penale (LPK) të Republikës së Maqedonisë së Veriut (RMV) në forcimin e sigurisë së gazetarëve duke komentuar veprimet e organeve të ndjekjes penale pavarësisht nëse bëhet fjalë për Prokurorinë Publike të RMV-së në rastet kur veprohet kur është paraqitur ndonjë krim ose kur veprojnë komisionet e kundërvajtjes në Ministrinë e Brendshme të RMV-së, në kushte kur bëhet fjalë për shkelje të raportuara.

Siguria e gazetarëve e kërcënuar nga shkelja e lirive dhe të drejtave të tyre gjatë punës është një problem që ka mbetur në Maqedoninë e Veriut për një kohë të gjatë dhe arriti kulmin në vitin 2014 kur shteti ra në vendin e 123, nga gjithsej 180 vende në indeksin e lirisë së shtypit të organizatës Reporterë pa Kufij. Për krahasim, RMV sipas të njëjtit indeks në vitin 2007 ishte në vendin e 36-të, që në atë periudhë ishte në pozitë më të lartë se disa demokraci perëndimore.

Një nga arsytet pse pas vitit 2014 vendi ishte në fund të indekseve botërore për lirinë e shprehjes dhe kishte kritika serioze në raportet e Komisionit Evropian janë pikërisht çështjet dhe zhvillimet lidhur me sigurinë e gazetarëve.

Gjegjësisht, të gjitha vendet, veçanërisht atyre të Evropës, kur kanë një numër të shtuar të sulmeve fizike dhe kërcënimeve mbi jetën e gazetarëve, ndërsa nuk ka asnjë vendim të gjykatave ose hetimet janë shmangur, atëherë reputacioni dhe besueshmëria e tyre para publikut evropian dhe botëror dëmtohet. Ky fenomen gjithashtu kontribuon në uljen e vlerave demokratike për shkak të mungesës së

forcës ose vullnetit të qeverive për të garantuar në mënyrë efektive sigurinë e aktorëve në sektorin e medias.

Sipas raportit të fundit të rregullt vjetor të Shoqatës së Gazetarëve të Maqedonisë, nga viti 2015 e deri më shtator të vitit 2020 janë regjistruar 75 raste të sulmeve ndaj gazetarëve dhe punonjësve mediatik të llojeve të ndryshme. Më poshtë janë rastet në të cilat janë shkelur të drejtat e punonjësve mediatik dhe kanë një rëndësi më të madhe juridike në aspekt të precedentëve që nuk janë zgjidhur nga gjykata ose kanë qenë të diskutueshme në publik ose janë gjykuar nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut në Strasburg:

- ▶ Përjashtimi i disa gazetarëve, kameramanëve dhe fotoreporterëve nga salla e Kuvendit të Maqedonisë më 24.12.2012, për të cilën shteti humbi një proces gjyqësor në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut në Strasburg në vitin 2017, i njohur si "Selmani dhe të tjerët kundër R. së Maqedonisë"¹;
- ▶ Arrestimi i gazetarit të gazetës "Nova Makedonija", Tomislav Kezharovski më 28.05.2013 për shkak të një artikulli që ai botoi në nëntor të vitit 2008 në revistën e atëhershme dy-javore "Reporter 92"²;
- ▶ Arrestimi i kryeredaktorit të portalit "Burevesnik", Zoran Bozhinovski më 21 Prill të vitit 2016, i cili u arrestua në Republikën e Serbisë, dhe më pas u ekstradua në RMV, i njëjti i pandehur në lëndën e famshme "Spiun", ndërsa në vitin 2020 u shpall i pafajshëm³;
- ▶ Sulmi ndaj një grupi gazetarësh dhe punëtorësh mediatik më 27 Prill të vitit 2017 gjatë ndërhyrjes së përfaqësuesve të nismës qytetare "Për Një Maqedoni të Përbashkët" në Kuvendin e Maqedonisë⁴.

1 Lënda e GjEDNj Selmani dhe të tjerët kundër Maqedonisë <https://hudoc.echr.coe.int/fre#%22itemid%22:%22001-170839%22>}} e publikuar në ueb-faqen e GjEDNj më 09.02.2017.

2 SHGM: Të refuzohet akt akuza kundër Kezharovskit [https://znm.org.mk/znm-da-se-otfrli-obvinenieto-protiv-ke/ lajmërim i SHGM, publikuar më 20 maj, viti 2019.](https://znm.org.mk/znm-da-se-otfrli-obvinenieto-protiv-ke/lajmërim%20i%20SHGM%20publikuar%20më%2020%20maj%20viti%202019)

3 SHGM përshëndet lirimin e Bozhinovskit [https://znm.org.mk/znm-ja-pozdravuva-osloboditelnata-pr/ lajmërim i SHGM, publikuar më 2 mars, viti 2020.](https://znm.org.mk/znm-ja-pozdravuva-osloboditelnata-pr/lajmërim%20i%20SHGM%20publikuar%20më%202%20mars%20viti%202020)

4 SHGM: Gazetarët kanë ngritur padi për sulmet e 27 prillit në Kuvend [https://mia.mk/znm-podneseni-tuzhbi-od-novinari-za-napadite-na-27-april-vo-sobraniето/ publikuar nga MIA më 27 prill, viti 2020.](https://mia.mk/znm-podneseni-tuzhbi-od-novinari-za-napadite-na-27-april-vo-sobraniето/publikuar%20nga%20MIA%20më%2027%20prill%20viti%202020)

Aktivitetet e SHGM-së për aktualizimin e çështjeve lidhur me sigurinë e gazetarëve

Aktivitetet e kryera nga SHGM në drejtim të aktualizimit të çështjeve lidhur me sigurinë e gazetarëve para publikut dhe organeve kompetente të pushtetit ekzekutiv dhe gjyqësor në vend janë:

Memorandumi për bashkëpunim i nënshkruar midis SHGM-së dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme më 29 dhjetor të vitit 2017, qëllimi i të cilit është të rrisë sigurinë e gazetarëve për shkak të sulmeve të shpeshta ndër vite, ku mbetën të pazgjidhur nga autoritetet kompetente sulmet që gazetarët dhe SHGM konsideruan se kanë elementë të krimeve ndaj gazetarëve. Praktika është që lëndët të mbeten në fazën e procedurës paraprake, pa urdhër nga prokurori kompetent për kryerjen e hetimit me shpjegimin se nuk janë mbledhur prova të mjaftueshme nga të cilat do të vërtetohej se ka elemente për një vepër penale ose se nuk është kryer ndonjë veprim i cili duhet të ndiqet sipas detyrës zyrtare dhe për këtë arsye nuk janë filluar procedura për kundërvajtje kundër autorëve, duke rezultuar në një numër të madh incidentesh të pazgjidhura në të cilat janë shkelur të drejtat e gazetarëve. Bashkëpunimi midis SHGM-së dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme për të sensibilizuar këtë problem u zhvillua në faza duke organizuar ngjarje publike të ndjekura nga pjesëtarë të policisë dhe punonjës mediatik dhe duke organizuar trajnime për policinë së bashku me Departamentin e Kontrollit të Brendshëm dhe Standardet Profesionale dhe Departamentin e Hetimit Penal në MPB. Ky bashkëpunim në fund të vitit 2019 rezultoi me nënshkrimin e **"Protokollit për marrëdhëniet midis pjesëtarëve të policisë dhe punonjësve mediatik"**, në të cilin janë definuar detyrimet që palët nënshkruese duhet t'i respektojnë. Protokoll që paraqet një azhurnim i Kodit të Gazetarëve të Maqedonisë⁵ dhe Kodit Etik të Policisë⁶ si një lloj akte vetërregulluese që janë të detyruar të respektohen nga anëtarët e të dy profesioneve gjatë kryerjes së detyrave të tyre.

Në vitet e fundit, **SHGM** ka bashkëpunuar deri diku edhe me Prokurorinë Publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Në takimet dhe ngjarjet me Prokurorin Publik, u theksuan problemet me të cilat përballen gazetarët dhe punonjësit mediatik

5 Kodi i gazetarëve të Maqedonisë - <https://znm.org.mk/kodeks-na-novinarite-na-makedonija/>

6 Kodi etik i policisë ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 72 nga 11.6.2007).

kur kërkojnë mbrojtjen e të drejtave të tyre para atij institucioni dhe kur kërkojnë ndjekjen penale të autorëve të veprave penale. Prokurori Publik i Republikës është informuar për rritjen alarmante të sulmeve ndaj gazetarëve dhe se në vitin 2020 (deri më tetor) SHGM-ja regjistroi 14 sulme, nga të cilat më shumë se gjysma janë kundër grave gazetare krahasuar me vetëm 4 sulme në vitin 2019. Sipas Prokurorisë Publike, vetëm në një rast, për sulm me kërcënim ndaj gazetarëve, ka pasur vendim nga Gjykata. Ky është rasti në lidhje me kërcënimet e bëra ndaj gazetares Meri Jordanovska⁷. Për shkak të atyre rrethanave dhe përmbushjes së misionit të SHGM-së, Prokurorit Publik të Republikës së Maqedonisë së Veriut iu dha rekomandim për të krijuar një departament të veçantë brenda prokurorisë⁸ që do të jetë i detyruar jo vetëm për ndjekjen penale të sulmeve ndaj gazetarëve dhe punonjësve mediatik që do të ndodhin në të ardhmen, por edhe për hetimin e rasteve të vjetra. Është sugjeruar që kjo është mënyra e vetme për të përmirësuar praktikën aktuale negative të mosndëshkimit. Ky propozim përkon gjithashtu me Rezolutën e Këshillit të të Drejtave të Njeriut 27/5 të 2 tetorit 2014, e cila adreson sigurinë e gazetarëve në Kombet e Bashkuara (KB) ku ndër të tjera thotë: (a) Krijimi i njësive speciale të hetimit ose komisione të pavarura; (b) Emërimi i prokurorëve të specializuar; .. ", si dhe konkluzionet e arritura nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) në një konferencë shtypi mbi sigurinë e gazetarëve në rajonin e OSBE, e mbajtur në Vilnius më 7-8 qershor, viti 2011. Në një prej përfundimeve thuhet: "... Policia dhe prokurorët duhet të zhvillojnë dhe përdorin protokolle dhe metoda të specializuara për të siguruar që hetimi i krimeve kundër gazetarëve do të përfshijë kontrole të hollësishme për të gjetur lidhje me punën e gazetarit", gjithashtu në kuadër të Këshillit të Evropës (KE) ekziston një dokument "Udhëzues për zbatimin e temave të zgjedhura nga Rekomandimi CM / Rec (2016) 4 mbi mbrojtjen e gazetarisë dhe sigurinë e gazetarëve dhe aktorëve të tjerë të mediave DGI (2020) 11" i cili thotë: "...Krijimi i njësive specifike brenda policisë, si dhe brenda prokurorisë, me ekspertizë specifike në të drejtat e njeriut dhe sigurinë e gazetarëve...".

Prokuroria Themelore dhe e Lartë Publike, në përgjigje të pyetjes: Pse nuk kanë vepruar pas raportimeve me propozime për ndjekje penale të paraqitura nga SHGM, ose gazetarë të tjerë, më së shpeshti janë përgjigjur se ata nuk janë kompetentë për të vepruar sipas detyrës zyrtare sepse në ato raste KP parashikon vetëm të drejtën e palës së dëmtuar për të ngritur padi penale private.

7 SHGM: Të ndëshkohet personi që iu kërcënua gazetares Meri Jordanovska <https://znm.org.mk/znm-da-se-kazni-liczeto-shto-se-zakani-na/>, publikuar më 11 janar, viti 2020

8 SHGM kërkon nga Prokuroria të krijojë departament për zgjidhjen e sulmeve ndaj gazetarëve <https://znm.org.mk/%d0%b7%d0%bd%d0%bc-%d0%b1%d0%b0%d1%80%d0%b0-%d0%be%d0%b4-%d0%be%d1%98%d0%be-%d0%bf%d0%be%d1%81%d0%b5%d0%b1%d0%bd%d0%be-%d0%be%d0%b4%d0%b4%d0%b5%d0%bb%d0%b5%d0%bd%d0%b8%d0%b5-%d0%b7%d0%b0-%d1%80%d0%b5/>

Kjo është arsyeja pse SHGM dhe Sindikata e Gazetarëve (SPGPM), në kuadër të grupit të punës në Ministrinë e Drejtësisë, qysh në tetor të vitit 2018, vunë në dukje nevojën për ndryshime në Kodin Penal në drejtim të mbrojtjes së gazetarëve dhe punonjësve mediatik në kryerjen e detyrave të tyre profesionale.

Në kërkesat për ndryshime në rregulloret penale ishte e theksuar nevoja për të futur vepra të reja penale të cilat do të titulloheshin "Parandalimi i gazetarëve në kryerjen e detyrave të tyre profesionale" dhe "Sulmimi i gazetarëve në kryerjen e detyrave të tyre profesionale" ose plotësimi i të deritanishmeve në drejtim të sanksionimit me dënime më të ashpra për të gjitha kërcënimet dhe sulmet fizike ndaj gazetarëve, punonjësve mediatik ose të afërmve të tyre, përfshirë këtu edhe vrasjen, për shkak të kryerjes së detyrave profesionale gazetareske. Kjo jo vetëm që do të mundësojë që Prokurori Publik të veprojë sipas detyrës zyrtare, por do të ndikojë ndjeshëm në forcimin e parandalimit të veçantë dhe të përgjithshëm.

Qëllimi i ndryshimeve të propozuara në Kodin Penal brenda grupit të punës të vitit 2018, por edhe me këtë botim, është që gazetarët të marrin mbrojtje më të madhe në kryerjen e detyrave të tyre profesionale. Mbrojtje që është në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe evropiane, por edhe me praktikën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut me qëllim që të krijohet një sistem më efikas të mbrojtjes së gazetarëve dhe që t'i vihet fund praktikës së mosndëshkimit për autorët e krimeve.

Mekanizmat multilateral ndërkombëtarë për mbrojtjen e gazetarëve dhe lirinë e shprehjes

Dhuna, ngacmimi dhe frikësimi i gazetarëve paraqesin sulme ndaj demokracisë me qëllimin e vetëm të mbyjtjes së lirisë së medias dhe lirisë së shprehjes duke privuar nga popullata mundësinë për të marrë vendimet e duhura në jetën reale, bazuar në informatat e vërteta.

Shtetet kanë një detyrim ta sigurojnë atë liri të shprehjes përmes mediave të lira dhe një mjedis që do të mundësojë debat publik të lirë, gjithëpërfshirës dhe pluralist. Për këto arsye, nevojiten korniza të reja dhe të përshtatshme ligjore, një klimë politike dhe socio-ekonomike e favorshme për mediat që do të mbështet procesin demokratik.

Korniza ligjore ndërkombëtare që është e rëndësishme dhe e rëndësishme për sigurinë e gazetarëve dhe aktorëve të tjerë të medias buron nga standardet e Kombeve të Bashkuara (KB), shteteve pjesëmarrëse të OSBE-së (OSBE), Bashkimit Evropian (BE) dhe Këshillit të Evropës (KE).

Kështu: Në vitin 2000, Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës përcaktoi termin gazetar si "çdo person fizik ose juridik i cili rregullisht ose profesionalisht merret me mbledhjen dhe shpërndarjen e informatave për publikun nëpërmjet çdo mjeti të komunikimit masiv".

Në vitin 2013, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara vuri në dukje se "gazetaria është në zhvillim e sipër dhe përfshin kontributin e institucioneve mediatike, individëve dhe një sërë organizatash të tjera që kërkojnë, marrin dhe transmetojnë informacione dhe ide të të gjitha llojeve përmes internetit, por edhe online."

Duke pasur parasysh diversitetin në rritje të aktorëve që kontribuojnë në debatin publik, gazetarët dhe liritë mediatike nuk duhet të lidhen ekskluzivisht me profesionin e gazetarisë. Në vend të kësaj, ekspertët e fushës theksojnë se këto liri janë gjithashtu thelbësore për bloggerët, gazetarët civil dhe sinjalizuesit, të cilët kanë një rol të rëndësishëm për të luajtur në rolin e mbikëqyrës publik.

Kombet e Bashkuara (KB)

Instrumentet juridike ndërkombëtare paraqesin një nga mjetet kryesore që janë në dispozicion të komunitetit ndërkombëtar, duke përfshirë këtu Kombet e Bashkuara (KB), në luftën për sigurinë e gazetarëve, si dhe në luftën kundër mosndëshkimit për veprat penale të kryera kundër gazetarëve në lidhje me aktivitetet e tyre gazetareske.

Më 13-14 shtator të vitit 2011, UNESCO ishte nikoqir i takimit të parë ndër-agjencial të KB për sigurinë e gazetarëve dhe çështjen e mosndëshkimit. Në takimin morën pjesë pothuajse të gjitha agjencitë relevante, fondet dhe programet përkatëse të KB-ve, duke përfshirë Zyrën e Komisionarit të Lartë për të Drejtat e Njeriut, Bankën Botërore dhe Programin e Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara.

Qëllimi kryesor ishte të krijohet një sistem i përgjithshëm dhe i koordinuar i KB në qasjen për parandalimin dhe luftimin e krimeve të dhunshme kundër gazetarëve - duke përfshirë sulme, rrëmbime, krime të dhunës seksuale, kërcënime, ngacmime, arrestime dhe paraburgime të paligjshme.

Takimi ishte pjesë e një procesi të konsultimeve, qëllimi përfundimtar i të cilit ishte miratimi i një plan veprimi të KB-së, i cili do të përfshinte krijimin e një mekanizmi të koordinuar ndër-agjencial për trajtimin e çështjeve që lidhen me sigurinë e gazetarëve dhe pandëshkueshmërinë. Mekanizmi do të monitoronte progresin si në shkallë kombëtare, ashtu edhe në shkallë ndërkombëtare. Këto ishin disa nga përfundimet kryesore:

„5.6. Ndhmoni shtetet anëtare që të zhvillojnë legjislacionin dhe mekanizmat që garantojnë lirinë e shprehjes dhe informimin, duke përfshirë, për shembull, kërkesat që shtetet të hetojnë në mënyrë efikase dhe të ndjekin penalisht veprat penale kundër lirisë së shprehjes;

5.7. Ndhmoni shtetet anëtare në zbatimin e plotë të rregullave dhe parimeve ekzistuese ndërkombëtare, si dhe në përmirësimin, kur është e nevojshme, të legjislacionit kombëtar për të mbrojtur gazetarët, profesionistët e medias dhe stafin në situata konfliktuale dhe jokonfliktuale;

5.8. Inkurajoni shtetet anëtare të marrin rol aktiv në parandalimin e sulmeve ndaj gazetarëve dhe të marrin masa në kohë në përgjigje të sulmeve duke krijuar mekanizma kombëtare për raste emergjente, të cilat palët e ndryshme të interesit mund t'i formojnë në mënyra të ndryshme;

5.9. Inkurajoni shtetet anëtare të respektojnë plotësisht Rezolutën 296 të Konferencës së Përgjithshme të UNESCO-së, me titull "Dënimi i Dhunës Ndaj Gazetarëve", e cila nxit shtetet anëtare të miratojnë parimin se nuk duhet të vjetërsohen lëndët gjyqësore për personat fajtorë për krime kundër lirisë së shprehjes; të rafinohet dhe promovohet legjislacioni në këtë fushë dhe të sigurohet që shpifja të mbetet një procedurë civile, dhe jo penale".

Për më tepër, në korrik të vitit 2011, Komiteti i KB për të drejtat e njeriut publikoi interpretimin e tyre të nenit 19 të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, i cili ka të bëjë me mbrojtjen e lirisë së mendimit dhe lirisë së shprehjes (Komenti i përgjithshëm nr. 34 lidhur me nenin 19).

Sipas komentit të përgjithshëm, nga të gjitha shtetet u kërkuar të futnin masa efektive për të mbrojtur gazetarët nga sulmet, të cilat kanë për qëllim t'i heshtin të gjithë ata që ushtrojnë të drejtën e tyre për lirinë e shprehjes dhe shpërndarjes së informatave.

Në komentin e tyre të përgjithshëm, Komiteti i të Drejtave të Njeriut identifikon gazetarët si një nga grupet që shpesh përballen me kërcënime të ndryshme, frikësime dhe sulme për shkak të aktiviteteve të tyre, së bashku me individë të tjerë të përfshirë në mbledhjen dhe analizimin e informatave mbi situatën e të drejtave dhe lirive të njeriut.

Format e atyre kërcënimeve dhe sulmeve janë identifikuar si "arrestim arbitrar, torturë, kërcënime për jetë dhe vrasje". Komenti i përgjithshëm thotë se të gjitha sulmet e tilla "duhet fuqimisht të hetohen në kohë të caktuar, autorët duhet të ndiqen penalisht dhe viktimat ose përfaqësuesit e tyre duhet të marrin dëmshpërblimin e duhur:

"Shtetet anëtare duhet të fusin masa efektive për të parandaluar sulmet që synojnë të heshtin ata që ushtrojnë të drejtën e tyre për lirinë e shprehjes ... Në asnjë rrethanë, sulmet ndaj ndonjë individi, për shkak të zbatimit të lirisë së tij të mendimit ose shprehjes, nuk mund të jetë në përputhje me nenin 19. Gazetarët shpesh u nënshtrohen kërcënimeve të tilla, frikësimeve dhe sulmeve për shkak të aktiviteteve të tyre. Gjithashtu, ka edhe njerëz që mbledhin dhe analizojnë informata mbi gjendjen e të drejtave të njeriut dhe që publikojnë raporte lidhur me të drejtat e njeriut, duke përfshirë këtu gjykatësit dhe avokatët. Të gjitha sulmet e tilla duhet të hetohen fuqimisht dhe në kohë të caktuar, ndërsa autorët duhet të ndiqen penalisht. Nga ana tjetër viktimat, ose, në rast të

vrasjes, trashëgimtarëve të tyre, duhet t'u jepet një formë e përshtatshme e dëmshpërblimit".

Përveç kësaj, në kuadër të KB-ve janë miratuar një numër të madh Rezolutash të veçanta që kanë për qëllim të ngritin nivelin e mbrojtjes së gazetarëve në vendet anëtare, por gjithashtu edhe për të dënuar gjendjen aktuale të mosndëshkimit e cila është mjaft e përhapur për veprimet e dhunës ndaj gazetarëve, dhe të cilat kanë të bëjnë me kryerjen e profesionit të tyre. Ato janë:

- › **Rezoluta 21/12 e 9 tetorit, viti 2012, mbi sigurinë e gazetarëve, e miratuar nga Këshilli i të Drejtave të Njeriut**, në të cilën thuhet:

"(Këshilli) shpreh shqetësimin e tij që sulmet ndaj gazetarëve shpesh herë kalojnë pa u ndëshkuar askush dhe (Këshilli) u bën thirrje shteteve që të sigurojnë përgjegjësi duke kryer hetime të paanshme, të shpejta dhe efektive për ato akte që bien në ingerencat e tyre, domethënë për të sjellë personat përgjegjës për sulmet para drejtësisë, si dhe t'u sigurojë viktimave qasje në mjetet juridike përkatëse".

- › **Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme të KB-ve 68/163 e 18 dhjetorit, viti 2013, mbi sigurinë e gazetarëve dhe çështjen e mosndëshkimit**, në të cilën ndër të tjerash thuhet:

"(Asambleja e Përgjithshme) u bën thirrje shteteve anëtare të bëjnë çmos për të parandaluar dhunën ndaj gazetarëve dhe punonjësve mediatik, të sigurojnë përgjegjësi duke kryer hetime të paanshme, të shpejta dhe efektive për të gjitha pretendimet e dhunës ndaj gazetarëve dhe punonjësve mediatik nën juridiksionin e tyre, dhe të sjellin autorët e krimeve të tilla para drejtësisë; (Asambleja e Përgjithshme) u bën thirrje shteteve të promovojnë një mjedis të sigurt për gazetarët për të kryer punën e tyre në mënyrë të pavarur dhe pa ndërhyrje të panevojshme, duke përfshirë zbatimin e: (a) masave ligjore; (b) ngritja e vetëdijes në gjyqësor dhe midis zyrtarëve të zbatimit të ligjit dhe personelit ushtarak, si dhe midis gazetarëve dhe shoqërisë civile, për të drejtat ndërkombëtare të njeriut dhe detyrimet ligjore humanitare lidhur me sigurinë e gazetarëve; (c) monitorimi dhe raportimi për sulmet ndaj gazetarëve; (d) dënimi publik i sulmeve ndaj gazetarëve; dhe (e) sigurimi i resurseve të nevojshme për të hetuar dhe ndjekur penalisht sulme të tilla (ndaj gazetarëve)".

- › **Rezoluta 27/5 e 2 tetorit, viti 2014, e Këshillit për të Drejtat e Njeriut, për sigurinë e gazetarëve**, në të cilën thuhet:

"(Këshilli) u bën thirrje shteteve të zhvillojnë dhe zbatojnë strategji për të luftuar mosndëshkimin për sulme dhe dhunë ndaj gazetarëve, duke përfshirë këtu edhe atë përmes përdorimit, kur është e përshtatshme, të praktikave të mira... ndër të tjerash: (a) Krijimi i njësisve të posaçme hetimore ose komisione të pavarura; (b) Emërimi i prokurorëve të specializuar; (c) Miratimi i protokolleve dhe metodave specifike të hetimit dhe ndjekjes penale; (d) Trajnimi i prokurorëve dhe gjyqësorit për sigurinë e gazetarëve; (e) Vendosija e mekanizmave të mbledhjes së informatave, siç janë bazat e të dhënave, për të mundësuar mbledhjen e informatave të verifikuara për kërcënimet dhe sulmet ndaj gazetarëve; (f) Vendosija e një mekanizmi për paralajmërim të hershëm dhe reagimi i shpejtë për t'u mundësuar gazetarëve qasje të menjëhershme tek autoritetet dhe masat mbrojtëse".

- › **Rezoluta 69/185 e Asamblesë së Përgjithshme të KB të 18 dhjetorit, viti 2014, mbi sigurinë e gazetarëve dhe çështjen e mosndëshkimit**, në të cilën thuhet:

"(Asambleja e Përgjithshme) dënon pa mëdyshje të gjitha sulmet dhe dhunën ndaj gazetarëve dhe punonjësve mediatik, siç janë tortura, vrasje pa gjyq, zhdukje me forcë, arrestime arbitrare dhe paraburgime arbitrare, si dhe kërcënime dhe ngacmime si në situata konfliktuale dhe jokonfliktuale; 2. Dënon ashpër pandëshkueshmërinë që mbizotëron për sulmet dhe dhunën ndaj gazetarëve dhe shpreh shqetësimin e saj të thellë që shumica dërrmuese e këtyre krimeve ngelin të pandëshkuar, gjë që nga ana tjetër kontribuon në përsëritjen e këtyre krimeve;

U bën thirrje shteteve anëtare që të bëjnë çmos për të parandaluar dhunën, kërcënimet dhe sulmet ndaj gazetarëve dhe punonjësve mediatik, të sigurojnë përgjegjshmëri duke kryer hetime të paanshme, të shpejta, të plota, të pavarura dhe efektive për të gjitha pretendimet e dhunës, kërcënimeve dhe sulmeve ndaj gazetarëve dhe punonjësve mediatik që janë nën juridiksionin e tyre për të sjellë dhunuesit, duke përfshirë këtu edhe ata që kanë urdhëruar sulmet, kanë ndihmuar për të kryer ose për të fshehur ndonjë vepër penale, para drejtësisë dhe për t'u siguruar viktimave dhe familjeve të tyre qasje tek mjetet juridike përkatëse."

- › **Rezoluta e Këshillit për Siguri 2222 (2015) nga 27 maji, viti 2015;** në të cilën thuhet:

"I bën thirrje shteteve anëtare të ndërmarrin hapat e duhura për të siguruar përgjegjësi për krimet e kryera kundër gazetarëve, profesionistëve të medias dhe stafit mbështetës në situata të konfliktit të armatosur dhe përmes kryerjes së hetimeve të paanshme, të pavarura dhe efektive brenda juridiksionit të tyre t'i sjellin autorët e veprave penale para drejtësisë.;

- › **Rezoluta 33/2 e 29 shtatorit, viti 2016, mbi sigurinë e gazetarëve,** në të cilën përsëritet se:

"Nxit shtetet të bëjnë gjithçka që është e mundur për të parandaluar dhunën, kërcënimet dhe sulmet ndaj gazetarëve dhe punonjësve mediatik, për të siguruar llogaridhënie duke kryer hetime të paanshme dhe në kohë, të plota, të pavarura dhe efektive për të gjitha pretendimet e dhunës, kërcënimeve dhe sulmeve ndaj gazetarëve dhe punonjësve mediatik në kuadër të juridiksionit të tyre, për të sjellë autorët e krimeve, përfshirë edhe ata që komandojnë, komplotojnë për të kryer, ndihmuar ose fshehur krime të tilla, para drejtësisë dhe për t'u siguruar viktimave dhe familjeve të tyre qasje në mjetet juridike përkatëse;

Më tej u bën thirrje shteteve që të zbatojnë në mënyrë më efektive kornizën ligjore ekzistuese për mbrojtjen e gazetarëve dhe punonjësve mediatik në mënyrë që të luftojnë pandëshkueshmërinë e cila është prezentë në shoqëri;

U bën thirrje shteteve që të harmonizojnë plotësisht ligjet, politikat dhe praktikat e tyre me detyrimet e tyre dhe detyrimet sipas ligjeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, dhe t'i rishqyrtojnë dhe, nëse është e nevojshme, t'i rishqyrtojnë ato, në mënyrë që të mos kufizojnë gazetarët dhe punonjësit mediatik në kryerjen e detyrave të tyre profesionale".

Ankesat dhe konkluzionet e mësipërme nga organet e Kombeve të Bashkuara u përsëriten vendeve anëtare përmes një **Rezolute të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme më 19 dhjetor të vitit 2017 dhe Rezoluta e miratuar nga Këshilli i të Drejtave të Njeriut më 27 shtator të vitit 2018,** me të cilat:

"Inkurajohen shtetet të sigurojnë përgjegjësi duke kryer hetime të paanshme, në kohë, të plotë, të pavarur dhe efektive për të gjitha akuzat për dhunë, kërcënimet dhe sulmet ndaj gazetarëve dhe punonjësve mediatik, për të sjellë autorët, duke përfshirë këtu edhe ata që kanë dhënë urdhër, kanë komplotuar për të

kyer, ndihmuar ose për të mbuluar krime të tilla, para fytyrës së drejtësisë, dhe të sigurojë që viktimat dhe familjet e tyre të kenë qasje në mjetet juridike përkatëse".

Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE)

Në konferencën rajonale të OSBE-së për sigurinë e gazetarëve, e mbajtur më 7-8 qershor të vitit 2011 në Vilnius, qeveritë dhe ekspertët ripohuan bindjen e tyre se mbrojtja e sigurisë së gazetarëve është thelbësore për të mbështetur qëllimet thelbësore të OSBE-së në favor të të gjithëve. Si rezultat i konferencës, u botua një publikim duke identifikuar çështjet që vendet pjesëmarrëse duhet të marrin në konsideratë në vlerësimin e asaj që mund të bëjnë për të përmirësuar klimën për gazetarët në vendet e tyre. Ky botim gjithashtu ofron një udhëzues praktik që përshkruan hapat që shtetet mund t'i ndërmarrin për të siguruar një mjedis miqësor për median. Këto masa, të zbatuara me vullnet të mirë nga shtetet pjesëmarrëse, mund të krijojnë një klimë të shëndetshme për zhvillimin e lirë të mediave të lira, përmes një kornize të përshtatshme normative të ligjeve.

Kështu, në pjesën e kërcënimeve dhe akteve të dhunës ndaj gazetarëve, thuhet se:

"Kërcënimet dhe aktet e dhunës ndaj gazetarëve kanë vazhduar dhe në disa pjesë madje janë rritur në zonën e OSBE-së në disa vitet e fundit. Kërcënimet e bëra përmes telefonit, faksit, postës elektronike ose letrës, etj., Shpeshherë janë të përcjella me sulme fizike, madje duke përfshirë këtu edhe vrasje.

Praktikë e mirë: "Autoritetet shtetërore duhet të hetojnë raportet e kërcënimeve në kohë sa më të shpejtë, në mënyrë të plotë dhe të marrin hapat e duhura për të mbrojtur individët e rrezikuar.

Qeveritë kanë për detyrë të mbrojnë sigurinë fizike të atyre që gjenden në rrezik. Ata duhet të marrin parasysh faktin që gazetarët, bloggerët dhe mbrojtësit e të drejtave të njeriut janë ndër grupeve më të rrezikuara në shoqëri dhe mund të sulmohen për shkak të aktiviteteve të tyre.

Organet për zbatimin e ligjit duhet të marrin hapa të prerë dhe të fuqishëm për të anuluar kërcënimet nga anëtarët e grupeve të krimin të organizuar.

Hetimi i sulmeve ndaj gazetarëve dhe vrasjeve të gazetarëve, duke siguruar që personat përgjegjës do të sillen para drejtësisë dhe të zhdukin pandëshkueshmërinë.

Numri i madh i sulmeve dhe vrasjeve të gazetarëve i shndërroi disa pjesë të rajonit të OSBE-së në vendet më të rrezikshmet për gazetarët; sundimi i ligjit dhe integriteti i sistemeve për zbatimin e ligjit dhe të drejtësisë vihen në dyshim; klima e mosndëshkimit po rritet.

Praktikë e mirë: Për këto krime nuk praktikohet afati i vjetërsimit të lëndëve. Të zbatohen hetime efikase dhe në kohë për t'u arrestuar individët që janë të përgjegjshëm për këto krime dhe të sillen para drejtësisë.

Policia dhe prokurorët duhet të zhvillojnë dhe përdorin protokolle dhe metoda të specializuara për të siguruar që hetimi i krimeve kundër gazetarëve përfshin kontrolle të hollësishme për të gjetur lidhje me punën e gazetarit."

Për më tepër, në kuadër të OSBE-së, nga ana e Këshillit të Ministrave, më 7 dhjetor të vitit 2018, është sjellë vendimi nr. 3/18, me titull Siguria e Gazetarëve, në të cilën Këshilli:

"Dënon publikisht dhe pa mëdyshje të gjitha sulmet dhe dhunën ndaj gazetarëve siç janë vrasja, tortura, zhdukja me forcë, arrestimi arbitrar, paraburgimi arbitrar dhe dëbimi arbitrar, frikësimi, ngacmimi dhe kërcënimet e të gjitha formave, siç janë ato fizike, ligjore, politike, teknologjike ose ekonomike, që përdoren për të zbuluar punën e tyre dhe / ose mbyllur pa nevojë zyrat e tyre, duke përfshirë këtu edhe situata konfliktuale;

Ai gjithashtu, dënon publikisht dhe pa mëdyshje sulmet ndaj grave gazetare që janë të motivuar nga puna e tyre, të tilla si ngacmimi seksual, abuzimi, frikësimi, kërcënimet dhe dhuna, duke përfshirë këtu edhe ato që bëhen përmes teknologjive digjitale.

Por gjithashtu, u bën thirrje shteteve për të:

"Marrin masa efektive për t'i dhënë fund mosndëshkimit për krimet e kryera kundër gazetarëve duke siguruar llogaridhënien si një element kryesor në parandalimin e sulmeve në të ardhmen, duke përfshirë këtu edhe sigurimin që agjencitë e zbatimit të ligjit janë duke i kryer hetimet në kohë të shpejtë, në mënyrë efektive dhe të paanshme për aktet e dhunës dhe kërcënimeve mbi gazetarët në mënyrë që të sjellin të gjithë ata që janë përgjegjës për sulmet para drejtësisë dhe për të siguruar që viktimat do të kenë qasje në mjetet juridike të përshtatshme".

Bashkimi Evropian (BE)

Sulmet fizike ndaj gazetarëve dhe aktorëve të tjerë të medias në BE mbeten të rralla dhe ndodhin më shpesh në kontekstin e tubimeve publike. Sidoqoftë, ngacmimet dhe kërcënimet përmes internetit janë të përhapura, veçanërisht në rrjetet sociale. Praktikrat e tilla, përfshirë edhe "trolling", shpesh u drejtohen gazetarëve dhe blogerëve. BE-ja thekson se "pa lirinë e shprehjes dhe lirinë e medias, qytetaria e informuar, aktive dhe e angazhuar është e pamundur". Për këto arsye, shtetet duhet të ndërmarrin hapa aktivë për të parandaluar dhunën duke promovuar një mjedis të sigurt të punës për gazetarët dhe aktorët e tjerë të medias, duke iu mundësuar kështu që të kryejnë punën e tyre në mënyrë të pavarur, pa ndërhyrje të panevojshme dhe pa frikë nga dhuna ose persekutimi.

"Puna e gazetarëve në zbulimin e abuzimeve të pushtetit, zbulimi i korrupsionit dhe verifikimi i mendimeve shpesh i vë ata në rrezik të veçantë të frikësimit dhe dhunës. Sulmet dhe kërcënimet e tilla - shpesh të shoqëruara me refuzimin e autoriteteve shtetërore për të kryer hetime efektive dhe mosndëshkimi për veprime të tilla - paraqesin një sulm jo vetëm ndaj viktimës, por gjithashtu mund të kufizojnë mundësinë që publiku të merr informata dhe ide. Përpjekjet për të mbrojtur gazetarët nuk duhet të kufizohen, por duhet të përfshijnë stafin mbështetës dhe të tjerët, siç janë "gazetarët civil", blogerët, aktivistët të rrjeteve sociale dhe mbrojtës të të drejtave të njeriut që përdorin media të reja për të arritur një audiencë sa më të madhe. Përpjekjet për t'i dhënë fund mosndëshkimit për krimet kundër gazetarëve dhe aktorëve të tjerë të medias duhet të lidhen me mbrojtjen e mbrojtësve të të drejtave të njeriut".

Siguria e gazetarëve dhe aktorëve të tjerë të medias është gjithashtu shqetësim për BE-në kur bëhet fjalë për situatën në vendet candidate - siç ishte e konfirmuar në **Udhëzimet e BE-së për Mbështetjen e Lirisë së Medias dhe Integritetit të Mediave në Vendet në Zgjerim, botuar nga Drejtoria e Përgjithshme për Zgjerim i Komisionit Evropian në shkurt të vitit 2014**. Në këtë fushë, BE-ja pret që vendet candidate "të ndërmarrin aktivitete pozitive për të siguruar dhe promovuar pluralizmin e mediave dhe pavarësinë e tyre". Një nga standardet për matjen është se "numri i sulmeve fizike, kërcënimeve dhe formave të tjera të frikësimit të mediave është në rënie".

Këshilli i Evropës (KE)

Në prill të vitit 2016, Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës miratoi një **Rekomandim për mbrojtjen e gazetarisë dhe sigurinë e gazetarëve dhe aktorëve të tjerë të medias**, duke e përshkruar si alarmant dhe të papranueshëm nivelin e kërcënimeve aktuale ndaj gazetarëve dhe aktorëve të medias në Evropë dhe duke siguruar udhëzime specifike për vendet-anëtare për të vepruar në fushat e parandalimit, mbrojtjes, ndjekjes penale, promovimit të informacionit, edukimit dhe ndërgjegjësimit.

Më saktësisht, nga shtetet-anëtare kërkohet të krijojnë korniza gjithëpërfshirëse normative për mbrojtjen e integritetit fizik dhe moral të gazetarëve dhe aktorëve të tjerë të medias. **Kjo nënkupton ndryshime të duhura në të drejtën penale për të parandaluar kryerjen e krimeve ndaj gazetarëve, por gjithashtu ndryshime që do të mundësojnë hetimin efektiv të veprimeve të kryera, në mënyrë që të parandalohet pandëshkueshmëria.** Përveç kësaj, për të krijuar dhe siguruar një mjedis të favorshëm për lirinë e shprehjes, shtetet-anëtare duhet t'u sigurojnë gazetarëve një gamë të gjerë të mbrojtjes në kryerjen e detyrave të tyre gazetareske, siç është mbrojtja e burimeve konfidenciale ose autonomia editoriale. Në Rekomandimin veçanërisht është theksuar që:

"17 Imperativ është që çdokush që është i përfshirë në vrasjet, sulmet dhe ngacmimet e gazetarëve dhe punonjësve të tjerë të medias të sillet para drejtësisë. Hetimet për krime të tilla dhe ndjekja penale e atyre që janë përgjegjës duhet të plotësojnë një numër kërkesash të përgjithshme. Kur ata që janë përgjegjës për krime të tilla nuk sillen para drejtësisë, mund të shfaqet kultura e mosndëshkimit.

18. Hetimet për vrasjet, sulmet dhe sjelljet e pahijshme duhet të jenë efektive në përmbushjen e kërkesave themelore të përkatësisë, tërësisë, paanësisë dhe pavarësisë, shpejtësisë dhe vëzhgimit publik.

19. Hetimet duhet të jenë efektive në kuptimin që ato janë të afta të përcaktojnë faktet, si dhe të identifikojnë dhe, në fund të fundit, të ndëshkojnë përgjegjësitet. Autoritetet duhet të ndërmarrin çdo hap të arsyeshëm për të mbledhur të gjitha provat në lidhje me incidentin. Gjetjet e hetimit duhet të bazohen në një analizë të hollësishme, objektive dhe të paanshme të të gjithë elementëve relevantë, duke përfshirë edhe verifikimin e lidhjes midis kërcënimeve dhe dhunës ndaj gazetarëve dhe aktorëve të tjerë të medias dhe kryerjes së punëve të tyre

gazetareske, ose duke kontribuar në mënyra të ngjashme në debatin publik. Autoriteteve shtetërore u kërkohet gjithashtu të hetojnë lidhjen e mundshme midis qëndrimeve raciste dhe një akti dhune. Gjithashtu, duhet të shqyrtohet edhe rëndësia e çështjeve të lidhura me përkatësinë gjinore.

24. Ligji duhet të parashikojë ndëshkime shtesë ose më të rënda për zyrtarët publikë të cilët, përmes neglizhencës, bashkëpunimit ose aktivizmit, veprojnë në një mënyrë që parandalon ose pengon hetimin, ndjekjen penale ose ndëshkimin e atyre që janë përgjegjës për krime kundër gazetarëve ose punonjësve të tjerë të medias.

25. Kur hetimet dhe ndjekjet penale nuk rezultojnë me sjelljen e autorëve të vrasjeve të gazetarëve ose krime të tjera të rënda para drejtësisë, shtetet anëtare mund të konsiderojnë krijimin e hetimeve të veçanta gjyqësore ose jashtëgjyqësore për raste specifike ose të krijojnë organe të specializuara të pavarura që të zbatojnë hetime të tilla në mënyrë të vazhdueshme. I dyti mund të ketë autoritet të veçantë dhe të përfshijë pjesëmarrjen ose udhëheqjen nga ana e mediave të respektuara dhe / ose figurave qytetare, në mënyrë që të avancojë procesin e gjetjes së fakteve, pa minimizuar detyrën e organeve hetimore për të ndjekur penalisht dhe ndëshkuar autorët. Shtetet kanë një detyrim pozitiv për të mbrojtur gazetarët dhe aktorët e tjerë të medias nga kërcënimet, frikësimet dhe dhuna, pavarësisht nga burimi i tyre, dhe pavarësisht se a janë motivet qeveritare, gjyqësore, fetare, ekonomike ose thjesht kriminale.

Për zbatimin e plotë të Rekomandimit në pjesën e mbrojtjes së gazetarëve dhe ndjekjes penale të autorëve të veprave penale kundër gazetarëve, Këshilli i Evropës miratoi një **Udhëzues për zbatimin e temave të zgjedhura nga Rekomandimi CM / Rec (2016) 4 për mbrojtjen e gazetarisë dhe sigurinë e gazetarëve dhe aktorëve të tjerë të mediave DGI (2020) 11.**

Ky dokument ka për qëllim të ndihmojë shtetet anëtare në zbatimin e zonave të zgjedhura të shtyllave të mbrojtjes dhe ndjekjes penale duke ndarë praktikat e mira përmes të cilave mund të arrihen objektivat e përcaktuara në dokument. Kështu, përmes këtij Udhëzuesi, për shembull, propozohet:

- I. *Krijimi i njësive specifike brenda policisë, si dhe brenda prokurorisë, me ekspertizë specifike për të drejtat e njeriut dhe sigurinë e gazetarëve, si një nga mënyrat që mund të përmirësojnë efikasitetin dhe paanësinë e hetimeve. Njësitë e tilla të specializuara duhet të trajnohen në përputhje me sugjerimet e dhëna në Seksionin II (B) (d) të Udhëzuesit;*
- II. *Ndryshime legislative për të siguruar eliminimin e afateve të vjetërsimit të lëndëve për ndjekjen penale të krimeve të dhunshme të kryera kundër gazetarëve dhe punonjësve të tjerë të medias;*
- III. *Amnistitë dhe faljet për krime të tilla duhet të jepen vetëm në raste të jashtëzakonshme;*
- IV. *Futja e dënimeve më të rrepta për zyrtarët publikë të cilët, nga neglizhenca, bashkëpunimi ose qëllimisht, veprojnë në një mënyrë që parandalon ose pengon hetimin, ndjekjen penale ose ndëshkimin e atyre që janë përgjegjës për këto krime;*
- V. *Duke pasur parasysh natyrën e tyre serioze, shtetet anëtare duhet të kategorizojnë veprat penale kundër lirisë së shprehjes si një kategori e veçantë e veprave penale, ose si një rrethanë rënduese që çon në dënime më të ashpra;*
- VI. *Autoritetet shtetërore të mbajnë të dhëna statistikore për numrin e ankesave të raportuara, hetimet e hapura, ndjekjet penale dhe dënimet në lidhje me kërcënimet, sulmet dhe vrasjet e gazetarëve dhe aktorëve të tjerë të medias. Këto të dhëna, ndër të tjerash, duhet të ndahen sipas gjinisë në mënyrë që të dokumentohet shkalla dhe serioziteti i problemit, duke përfshirë edhe shkallën e mosndëshkueshmërisë, në mënyrë që të zhvillohen strategjitë për të zgjidhur problemet.*

Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës ka miratuar **Rezolutën e fundit 2317 (2020)**, e cila u bën thirrje shteteve anëtare që të mbrojnë në mënyrë më efektive sigurinë e gazetarëve dhe lirinë e mediave. Në lidhje me këtë kërkesë, Kuvendi tregon se ata duhet:

- › të zbatojnë plotësisht Rekomandimin CM / Rec (2016) 4 për mbrojtjen e gazetarisë dhe sigurinë e gazetarëve dhe aktorëve të tjerë të medias;

- › të zbatojnë një hetim efikas, të pavarur dhe të shpejtë për çdo krim kundër gazetarëve, siç janë vrasjet, sulmet ose ngacmimet dhe të sjellin para drejtësisë autorët, nxitësit dhe bashkëpunëtorët të cilët janë përgjegjës sipas ligjit, duke siguruar që nuk do të ketë mosndëshkim për sulmet ndaj gazetarëve;
- › të vendosin mekanizma kombëtare në përputhje me Planin për Veprime të Kombeve të Bashkuara për sigurinë e gazetarëve dhe çështjen e mosndëshkimit, duke siguruar që mekanizmat e tillë janë të hartuara dhe të zbatuara nën udhëheqjen e fortë politike dhe operacionale, me koordinimin e duhur ndër-agjencor dhe në partneritet të mirëfilltë me shoqërinë civile, në veçanti me shoqatat e gazetarëve, sindikatat dhe organizatat e lirisë së medias;
- › të fillojnë një luftë të vendimtare kundër online ngacmimeve të gazetarëve, veçanërisht grave gazetare, dhe gazetarëve që i përkasin grupeve të pakicave, dhe të përforcojnë mbrojtjen e gazetarëve hulumtues dhe sinjalizuesve;
- › të krijojnë mekanizma të paralajmërimit të hershëm dhe reagimit të shpejtë, siç janë linjat telefonike ose pikat e kontaktit për raste emergjente, për të siguruar që gazetarët kanë qasje të menjëhershme në mbrojtje gjithmonë kur pranojnë kërcënime;
- › të përforcojnë bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informatave, ekspertizës dhe praktikave më të mira me vendet e tjera sa herë që sulmet ndaj gazetarëve përfshijnë dimensione ndërkufitare.

Praktika e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut për mbrojtjen e profesionit të gazetarisë dhe të drejtën e lirisë së shprehjes

Gjykata e Strasburgut ka theksuar vazhdimisht rëndësinë e lirisë së shprehjes si një nga parimet themelore të një shoqërie demokratike, duke pranuar rolin shumë të rëndësishëm që luajnë mediat sot: nga njëra anë, në sigurimin e informacionit të verifikuar dhe të saktë për publikun, por, nga ana tjetër, dhe roli si "mbikëqyrës publik". Mediat kanë për detyrë të sigurojnë informata dhe ide me interes publik, duke mos tejkalar kufijtë e kësaj lirie, dhe ky detyrim lind nga e drejta e publikut për të marrë informata të tilla.

Nëse shteti disponon me informata për kërcënime ose frikësime të gazetarëve ose organizatave mediatike, atëherë ai është i detyruar të marrë masa mbrojtëse dhe të kryejë një hetim efektiv për t'i kontrolluar informatat e tilla.

Obligimi për mbrojtjen e jetës

Neni 2 i Konventës (mbrojtja e të drejtës të jetës) përfshin një ndalim të marrjes me dashje dhe të paligjshme të jetës, por gjithashtu edhe një detyrim pozitiv për autoritetet për të ndër marrë hapat e duhura për të mbrojtur jetën. Detyrimi për të mbrojtur jetën ka dy elemente themelore:

(I) detyra e shtetit për të siguruar të drejtën për jetë duke vendosur dispozita efektive të ligjit penal për të parandaluar kryerjen e veprave penale kundër një personi, të mbështetur nga një mekanizëm i zbatimit të ligjit për të parandaluar, zbuluar dhe ndëshkuar kur dispozitat janë shkelur; dhe

(II) në rrethana të caktuara, shteti ka një detyrim pozitiv për të marrë masa operative parandaluese për të mbrojtur individin ose personat, jeta e të cilëve është e rrezikuar nga krimet e kryera nga një person tjetër.

Kështu, për shembull, Gjykata gjeti një shkelje të Nenit 2 të Konventës në lëndën **Dink kundër Turqisë**⁹ në të cilën bëhet fjalë për vrasjen e gazetarit Hrant Dink. Gazetari Dink ka qenë prej kohësh objekt i një armiqësie të ashpër dhe kërcënimeve

9 Lënda në GjEDNJ: Dink v Turkey, Nos. 2668/07, 6102/08, 30079/08, 7072/09 & 7124/09, 14.9.10

nga nacionalistët ekstremistë si rezultat i artikujve të tij lidhur me raportet turko-armene në një gazetë ditore. Gjykata gjeti se ishte e arsyeshme të supozohej se autoritetet ishin informuar për armiqësinë e Z. Dink, se organet për zbatimin e ligjit kanë qenë të informuar për një kërcënim real për jetën e tij, por që ata nuk kishin arritur të merrnin masa të arsyeshme për të parandaluar dhe mbrojtur këtë rast.

Obligimi të hetohen rastet e vdekjes

Neni 2 i Konventës kërkon një hetim efektiv sa herë që ekziston një marrje e paligjshme e jetës, qoftë e kryer nga zyrtarë ose individë privatë. Cilësitë themelore të një hetimi duhet të jenë këto:

autoritetet duhet të veprojnë sipas detyrës zyrtare, me fjalë të tjera, nuk

1. duhet kërkuar iniciativë nga ndonjë i ngushtë për të filluar një hetim

hetimi duhet të jetë i pavarur nga personat e përfshirë në ngjarje

- 2.
3. hetimi duhet të jetë efektiv në mënyrë që të përcaktojë nëse forca e përdorur ishte e justifikuar ose jo, dhe të identifikojë dhe ndëshkojë ata që janë përgjegjës

ekziston kërkesë për urgjencë dhe efikasitet të arsyeshëm të hetimit

- 4.
5. kërkuar duhet t'i sigurohet qasje efikase në procedurën e hetimit
6. duhet të ketë element të kontrollit publik mbi hetimin ose rezultatet e tij,
6. i mjaftueshëm për të siguruar përgjegjësi në praktikë, domethënë për të ruajtur besimin e publikut

Kështu për shembull, në lëndën **Kilic v Turkey**¹⁰, kishte një shkelje të nenit 2 për shkak të fushës së kufizuar dhe kohëzgjatjes së shkurtër të hetimit për vrasjen e gazetarit Kiliç.

10 Lënda në GjEDNJ: Kilic v Turkey, No. 22492/93, 28.3.00

Ndalimi i torturës dhe keqtrajtimit

Neni 3 i Konventës përfshin detyrimet ndaj autoriteteve për të parandaluar dhe hetuar keqtrajtimin e gazetarëve që vjen nga palë të treta private (ekuivalente me detyrimet e diskutuara më lart në lidhje me të drejtën për jetë). Kjo është arsyeja pse hetimet që përfshijnë akuza serioze për veprime jo të drejta duhet të jenë të hollësishme dhe efektive, që do të thotë se autoritetet duhet gjithmonë të bëjnë një përpjekje serioze për të gjetur se çfarë ka ndodhur në të vërtetë, dhe të mos mbështeten në përfundime të nxituara ose të pabazuara për t'i mbyllur hetimet e tyre.¹¹

Gjykata njihet rolin e veçantë që kanë luajtur gazetarët hulumtues. Gjykata nënvizon se roli i gazetarisë hulumtuese është të informojë dhe lajmërojë publikun për fenomene të padëshirueshme në shoqëri menjëherë pasi që të marrin informatat relevante për atë.¹²

11 Rizvanov v Azerbaijan, No. 31805/06, 17.4.12, para. 56; Najafli v Azerbaijan, No. 2594/07, 2.10.12, para. 4.

12 Martin and others v France, No. 30002/08, 12.4.12, para. 80.

Shqyrtim krahasues i ligjeve penale/civile të Finlandës, Francës dhe Gjermanisë në lidhje me dispozitat për mbrojtjen e gazetarëve nga aspekti i kërcënimeve dhe frikësimeve të kryera përmes rrjeteve sociale/internetit

Ngacmimet dhe abuzimet në internet janë përhapur sot përmes përdorimit të platformave të rrjeteve sociale dhe hapësirave të tjera digjitale të përmbytura nga aktivitete armiqësore dhe kërcënuese. Grupi i targetuar i këtij ngacmimi dhe abuzimi janë gazetarët, dhe posaçërisht gratë gazetare. Një studim i fundit nga Amnesty International zbuloi se një në çdo 14 porosi në Twitter drejtuar grave gazetare ishte ofenduese ose e dëmshme dhe armiqësore. Ka shumë mënyra në të cilat një gazetar mund të ngacmohet ose abuzohet në internet, dhe disa nga këto metoda kanë të njëjtin efekt të ngacmimit ose abuzimit që njerëzit përjetojnë në botën reale.

"Mbikëqyrja/ndjekja në Internet": Kjo është mënyra se si shumica e njerëzve e kuptojnë ngacmimin përmes komunikimeve në rrjetet sociale. Kjo është kur një individ i dërgon një numër të konsiderueshëm mesazhesh të padëshiruara ndonjë personi tjetër (dmth. "komunikime të drejtpërdrejta") që shkaktojnë ngacmime ose forma të tjera dëmtimi personit të cilit i drejtohen, përmes postës elektronike ose drejtpërdrejt viktimës përmes internetit. Kjo përfshin edhe praktikën e "etiketimit" ose "përmendjes" në rrjetet sociale si një formë e "bisedës kompjuterike" me ta. Kjo është praktikë kur, duke përdorur simbolin "@", të ndjekur me emrin e përdoruesit të viktimës, përdoruesi mund të njoftojë viktimën se është përmendur në ndonjë post specifik. Në këtë drejtim, praktika e "etiketimit" ose "@-përmendjes" së vazhdueshme të një individi mund të rrënjosë të njëjtat ndjenja ankthi ose frike siç mund të shkaktohen nga kontakti i përsëritur i drejtpërdrejtë përmes kanaleve private të komunikimit. Për më tepër, viktimat zakonisht do të njoftohen sa herë që postimi origjinal "etiketimi" ose "@-përmendja" pëlqehet nga ndonjë përdorues tjetër i platformës së rrjetit social, që mund të përforcojë dhe përkeqësojë ndikimin e komunikimit ose madje të kthejë një mesazh në mesazh që përsëritet.

Dërgimi i mesazheve frikësuese, kërcënuese ose abuzive: Abuzimi përmes internetit mund të marrë gjithashtu formën e mesazheve tepër frikësuese, agresive dhe kërcënuese që e bëjnë individin të frikësohet për sigurinë e tij personale. Ka shembuj të individëve që krijojnë ueb faqe kushtuar monitorimit dhe kritikimit, postimit të profileve të rreme, titujve të fotoshopuar dhe postimeve të trilluara të rrjeteve sociale që synojnë të dëmtojnë besueshmërinë e viktimës dhe ta nënshtrijnë atë në abuzim.

Fushatat për ngacmime përmes internetit: Kjo është mënyrë që një person të përjetojë një fushatë të vazhdueshme ngacmimi nga një varg individësh të ndryshëm. Kjo fushatë mund të jetë e koordinuar, ose mund të zhvillohet pa organizim paraprak. Për shembull, mund të fillojë me një mesazh të vetëm nga një përdorues i cili më pas provokon shumë përdorues të tjerë që t'i dërgojnë viktimës mesazhe ofenduese, të dhunshme, frikësuese dhe armiqësore. Ky lloj aktiviteti shpesh nuk hynë në definicionin ligjor të "ngacmimit" në shumë juridiksione, pasi praktikisht çdo aktor dërgon vetëm një mesazh që nuk është domosdoshmërisht serioz ose i paligjshëm. Sidoqoftë, kur shikohet në kontekst, ajo kontribuon në një fushatë gjithëpërfshirëse të ngacmimit që mund të ketë një ndikim të madh mbi gazetarin dhe aftësinë e tij ose të saj për të bërë punën e tij / saj.

"Doksing": Kjo është një praktikë online e hulumtimit dhe shpërndarjes së informatave personale të individit - të tilla si numri telefonik ose adresa e postës elektronike dhe adresa e shtëpisë - në një mjedis që praktikon ose nxit kërcënime ose frikësime ndaj atij personi. Kjo më pas mund të çojë ose të inkurajojë fenomenin e fushatave të ngacmimit në internet, pasi një grup i madh njerëzish marrin informacionin që u nevojitet për të kontaktuar viktimën drejtpërdrejtë.

Përfaqësim i rremë dhe trolling përmes internetit: Kjo më shpesh përfshin mesazhe ose komunikime të dëmshme për ndonjë person të caktuar të dërguara nga person tjetër, sesa drejtpërdrejtë tek viktimë (dmth. "komunikimet indirekte"). Këto komunikime mund të vijnë më pas në dijeninë e viktimës dhe të shkaktojnë ankth, stres ose frikë.

Finlanda

Kodi Penal i Finlandës përfshin dy dispozita që kanë të bëjnë me komunikime fyese ose kërcënuese, dhe këto dispozita mund të zbatohen në online kontekst. E para nga këto dispozita quhet akti i "ndjekjes".

Kapitulli 25, Pjesa 7 (a) nga Kodi Penal - Ndjekje

Një person i cili vazhdimisht kërcënohet, monitoron, kontakton ose në mënyrë të ngjashme dhe të paarsyeshme ndjek dikë tjetër, në mënyrë që të shkaktojë frikë ose ankth tek personi që ndiqet, do të dënohet për ndjekje me gjobe ose me burgim për maksimum dy vjetësh, përveç nëse është parashikuar ndonjë dënim tjetër i barabartë ose më i ashpër diku tjetër në ligjin për atë vepër penale.

Elementet thelbësore të veprës penale janë se ajo bëhet kur një person "vazhdimisht kërcënon, vëzhgon, kontakton ose në mënyrë të ngjashme përndjek padrejtësisht ndonjë individ tjetër, në mënyrë që të fut frikë ose ankth tek personi tjetër". Gjatë përcaktimit nëse veprimet e përsëritura të kryera nga i pandehuri kanë shkaktuar frikë ose ankth tek viktimën, gjykatat duhet të marrin në konsideratë pozicionin e viktimës (për shembull, nëse vuajnë nga një cenueshmëri e veçantë ose nëse viktimën është fëmijë). Për më tepër, vepra penale duhet të ketë qëllim të caktuar. I pandehuri duhet të kuptojë se kontakti i tij ose i saj ose veprime të tjera ndoshta shkaktojnë frikë ose ankth tek viktimën.

Lidhur me llojin e komunikimeve në internet që do të mbulohen me këtë vepër penale, përdorimi i termit "kontakt" sipas Kapitullit 25, pjesa 7a e Kodit Penal duket se nënkupton që vepra do t'i referohet vetëm "komunikimeve të drejtpërdrejta" me viktimën dhe jo mesazhet dërguar palëve të treta ose publikuar publikisht në internet. Sidoqoftë, gjykatat ende mund të vendosin të zbatojnë dispozitat për disa komunikime në internet që i drejtohen viktimës përmes "etiketimit" ose "@-përmendjes".

Vepra penale i referohet vetëm komunikimeve "të përsëritura" dhe nuk duket se mbulon komunikime të dëmshme të njëhershme (të tilla si mesazhet kërcënuese ose mesazhe që rezultojnë në fushata "ngacmimi"). Kur bëhet fjalë për komunikimin fytes të njëhershëm, krimi i "kërcënimit" mund të aplikohet. Sipas kësaj dispozite, do të konsiderohet vepër penale nëse një person "kërcënon tjetrin në mënyrë që personi në rrezik do të ketë arsye të arsyeshme për të besuar se siguria personale ose prona e tij është në rrezik serioz".

Finlanda ndalon përhapjen e informatave që shkelin të drejtën e jetës private. Përveç kësaj, dëmtimet që mund të konsiderohen si më serioze dënohen me burg deri në dy vjet.

Kapitulli 24, Pjesa 9 nga Kodi Penal - Shpifje

(1) Një person i cili përhap informata të rreme ose insinuata të rreme për ndonjë person tjetër, në mënyrë që veprimi të jetë i favorshëm për t'i shkaktuar dëm ose vuajtje atij personi, ose për ta nënshtruar atë person në përçmim ose nënçmim në ndonjë mënyrë tjetër të definuar në paragrafin (1), do të dënohet për shpifje me gjobë.

(2) Gjithashtu, do të dënohet për shpifje edhe personi që përhap informata të rreme ose insinuata të rreme për ndonjë person të vdekur, në mënyrë që akti do të shkaktojë vuajtje tek personi me të cilin i ndjeri ishte i afërt.

(3) Kritika e drejtuar ndaj aktiviteteve të një personi në politikë, biznes, zyrë publike, funksione publike, shkencë, art, ose në një veprimtari të krahasueshme publike, dhe që padyshim nuk shkon përtej kufijve të përshtatshmërisë, nuk është shpifje e renditur në nënparagrafin 1 (2).

(4) Paraqitja e një gjykimi në shqyrtimin e një çështjeje me rëndësi të përgjithshme, gjithashtu nuk konsiderohet si shpifje nëse prezantimi i tij, duke marrë parasysh përmbajtjen e tij, të drejtat e të tjerëve dhe rrethana të tjera, nuk tejkalon qartë atë që mund të konsiderohet si e pranueshme.

Kapitulli 24, Pjesa 10 nga Kodi Penal – Shpifje e rëndë

Nëse, në shpifjen nga neni 9 (1), shkaktohet vuajtje e konsiderueshme ose dëm i konsiderueshëm dhe shpifja rëndohet, gjithashtu, kur vlerësohet si një e tërë, kryesi do të dënohet për shpifje të rëndë me gjobë ose me burgim deri në dy vjet.

Kapitulli 5, Pjesa 5 nga Kodi Penal - nxitje

Një person i cili me qëllim bind një person tjetër të kryejë veprë penale ose të bëjë një përpjekje të dënueshme për një veprë të tillë do të dënohet për nxitjen e veprës sikur ai ose ajo të ishte kryerësi.

Franca

Neni 222-17 i Kodit Penal të Francës parashikon që kërcënimi për të kryer një veprë penale dënohet deri në gjashtë muaj burg ose me gjobë (7,500 €). Prandaj, kjo dispozitë mbulon kërcënimet për të vrarë, sulmuar ose përdhunuar viktimën. Në rastet kur kërcënimi është me vdekje, dënimi rritet në tre vjet burg dhe një gjobë prej 45,000 euro.

Krimi është kryer aty ku kërcënimi është bërë me një dokument të shkruar, foto ose ndonjë mjet tjetër. Një kërcënim i tillë mund të jetë me kërcënime me shkrim ose vizuale të bëra në internet. Për më tepër, ajo mbulon kërcënimet që janë bërë një herë dhe nuk kërkon përsëritje të kërcënimit në mënyrë që të ndiqet penalisht.

Neni 222-17 nga Kodi Penal i Francës - Kërcënim

Një kërcënim për të kryer krim ose kundërvajtje ndaj ndonjë personi, një përpjekje për të kryer veprë penale që është e dënueshme, dënohet me burgim me kohëzgjatje prej gjashtë muaj dhe me gjobë prej 7,500 euro, nëse përsëritet ose dëshmohet me dokument të shkruar, fotografi ose ndonjë objekt tjetër.

Dënimi rritet në tre vjet burg dhe gjobë prej 45,000 euro në rastet ku kërcënimi është me vdekje.

Në mënyrë që të fillohet një ndjekje penale e suksesshme, duhet të tregohet se individi kërcënuet synonte të kërcënonte individin me ndonjë veprë penale, dhe se kryesi e dinte dhe kishte për qëllim të krijonte frikë dhe çrregullim mendor tek viktimia.

Ekziston edhe një dispozitë tjetër që mund të mbështet ndjekjen penale për kërcënime në internet. Ky është neni 222-16 i Kodit Penal, i cili penalizon thirrjet apo mesazhet që kanë qëllim të keq, ku përfshihen porositë në e-mail, por edhe WhatsApp. Kjo veprë kërkon minimumi dy tekste ose thirrje, sepse veprimet duhet të zhvillohen "në vazhdimësi", dhe gjykatësit marrin parasysh kornizën kohore në të cilën ndodhin ato veprime, domethënë ndërlidhjen e tyre. Kjo ka përdorim të kufizuar në trajtimin e ngacmimeve të gazetarëve në internet, pasi kërkon që kërcënimet të dërgohen në mesazhe direkte dhe private. Prandaj, nuk do të mbulojë ngacmimet përmes faqeve publike (ose etiketimeve) në rrjetet sociale dhe aktivitete të tjera të ngjashme në internet.

Gjermania

Siç duket ligjet gjermane nuk përmbajnë ndonjë dispozitë specifike për të mbrojtur gazetarët nga ngacmimet në internet. Sidoqoftë, mund të zbatohen dispozitat e përgjithshme për mbrojtjen nga veprimet e ngacmimit. Ato përfshijnë dispozita të së drejtës civile dhe penale lidhur me spiunazhin e të dhënave, sulmin, ndjekjen, fyerjen dhe shpifjen.

Praktika e "doksing", që nënkupton publikimin e informatave private ose personale për viktimën në internet, mund të konsiderohet si spiunazh e të dhënave ose kryqëzim i të dhënave. Kodi Penal përcakton që personat të cilët mbledhin të dhëna personale që janë të mbrojtura, të cilat nuk ishin të destinuara për autorët e krimeve duke anashkaluar atë mbrojtje, dhe kështu ua bëjnë të dhënat të disponueshme palëve të treta, mund të dënohen me burgim deri në tre vjet ose me gjobë.

Ngacmimi i gazetarëve përmes internetit mund të jetë i dënueshëm si ndjekje e paligjshme. Neni 238 i Kodit Penal penalizon përgjimin e paligjshëm të një personi në përpjekje për të vendosur kontakte me të përmes telekomunikacionit. Për më tepër, kërcënimi i një personi ose një personit të afërt me humbje të jetës ose gjymtyrëve, dëmtim të shëndetit ose privim të lirisë është gjithashtu vepër penale.

Këto vepra penale duhet të kryhen në mënyrë të përsëritur dhe të jenë në gjendje të prishin seriozisht stilin e jetës së një personi, që do të thotë se personi është, për shembull, i detyruar të ndryshojë seriozisht aktivitetet e tij në kohë të lirë si rezultat i kërcënimeve.

Ngacmimi në internet gjithashtu mund të dënohet si sulm, me dënim me burg jo më shumë se pesë vjet ose me gjobë. Në përgjithësi, sulmi është i kufizuar në një sulm fizike. Megjithatë, nëse ngacmimi në internet është aq serioz sa rezulton në simptoma somatike, ai mund të dënohet sipas kësaj dispozite.

Sipas Kodit Penal të Gjermanisë, ekzistojnë disa dispozita që ndalojnë fyerjen dhe përhapjen e informacionit të rremë personal, dhe vërtetësia e tyre nuk mund të provohet. Pragu është që informacioni të jetë në gjendje të shpifë një person ose të ndikojë negativisht në opinionin publik për personin në fjalë.

Fyerja dënohet me burgim jo më shumë se një vit ose me gjobë.

Shpifja dënohet me burgim për një periudhë jo më të gjatë se një vit ose me gjobë, dhe nëse është bërë në publik ose me shpërndarje të materialeve të shkruara, dënohet me burgim që nuk i kalon dy vjet ose me gjobë. Nëse shpifja kryhet qëllimisht, kohëzgjatja e burgimit nuk mund të kalojë dy vjet, ose gjobë; nëse shpifja është kryer në publik, në një takim ose përmes shpërndarjes së materialeve të shkruara, ai do të dënohet me burgim jo më shumë se pesë vjet ose me gjobë.

Fyerja, shpifja dhe shpifja e qëllimshme ndiqen penalisht vetëm me kërkesë të viktimës. Megjithatë, prokurori publik do të hapë një hetim vetëm nëse është në interes të publikut.

Raporte ndërkombëtare dhe obligimet e shtetit lidhur me sigurinë e gazetarëve dhe punonjësve mediatik

Nevoja për të ndryshuar Kodin Penal të Republikës së Maqedonisë së Veriut është vërejtur në disa raporte ndërkombëtare të organizatave të ndryshme politike shtetërore dhe ndërkombëtare të cilat përmes tyre apelojnë që mosndëshkimi i autorëve të veprave penale të dhunshme ndaj gazetarëve dhe frikësimit çon në vetëcensurë. Në këtë pjesë ju paraqesim disa nga rekomandimet.

Më 11 mars, viti 2020, u botua Raporti i Stejt Departamentit të SHBA-së për vitin e kaluar (2019) mbi respektimin e të drejtave të njeriut në Maqedoninë e Veriut. Në raportin thuhet se vendi ka bërë përparim në respektimin e lirisë së medias dhe lirisë së shprehjes. Megjithatë, Stejt Departamenti vëren se ka ende probleme që kanë vazhduar në vitet e fundit, të tilla si dhuna dhe frikësimi i gazetarëve..¹³

Më tutje thotë:

Në këtë raport të Stejt Departamentit vëmendje të posaçme u kushtohet kërcënimeve, etiketimeve dhe frikësimeve të gazetarëve nga ana e politikanëve. Në këtë kontekst, janë përmendur citime nga reagimet e SHGM-së dhe zyrtarëve të lartë të Komisionit Evropian ku theksohet se kjo mund të çon në vetëcensurë, duke u bërë thirrje autoriteteve që të tregojnë tolerancë zero për sulmet dhe kërcënimet ndaj gazetarëve.

Në raportin vjetor të Komisionit Evropian për RMV-në, në seksionin për lirinë e shprehjes thuhet se vendi ka një nivel të caktuar të përgatitjes dhe është mesatarisht i përgatitur në fushën e lirisë së shprehjes dhe se ka bërë progres të kufizuar gjatë periudhës së raportimit.

Për më tepër, ky raport, në pjesën që lidhet me detyrat e shtetit dhe me temën për sigurinë e gazetarëve dhe politikën e mosndëshkimit, thotë se "vendi duhet të sigurojë monitorim të shpejtë dhe efikas të rasteve të dhunës fizike dhe verbale ndaj gazetarëve dhe zbatimin e ligjit nga autoritetet gjyqësore".¹⁴

13 Stejt Departamenti: Mbetet problemi me mosndëshkimin e sulmeve të gazetarëve <https://znm.org.mk/stejt-departmentot-ostanuva-problem/>

14 Raporti i Komisionit Evropian për Republikën e Maqedonisë së Veriut (06.10.2020 / SWD(2020) 351 final) https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/north_macedonia_report_2020.pdf

Në kuadër të Këshillit të Evropës, që nga dhjetori i vitit 2014, është duke funksionuar Platforma për Promovimin e Mbrojtjes së Gazetarisë dhe Sigurisë së Gazetarëve¹⁵. Kjo platformë është një hapësirë publike ku regjistrohen, përpunohen dhe publikohen incidente dhe rreziqe që lidhen me lirinë e medias dhe sigurinë e gazetarëve në vendet anëtare të Këshillit të Evropës, të cilat garantohen nga neni 10 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.¹⁶

Platforma mundëson monitorimin e të gjitha rasteve të sulmeve ndaj gazetarëve sipas viteve, duke filluar nga viti 2014 kur u krijua (shih: fotografinë 1). Përmes platformës mund të shohim se cilat prej rasteve janë "zgjidhur" për të cilat ekziston raport nga një organ i shtetit anëtar, pastaj mbahen statistika nëse ndonjë gazetar është në paraburgim dhe nëse ekzistojnë raste të mosndëshkimit për vrasjen e gazetarëve. Përmes platformës regjistrohen të gjitha rastet e sulmeve ndaj gazetarëve dhe punonjësve mediatik dhe ofron mundësi për të monitoruar veprimet e autoriteteve në raste specifike. (shih: fotografinë 2). Siç mund ta shohim, shtetet anëtare të Këshillit të Evropës në këtë rast dhe RMV mund të përdorin platformën dhe të japin përgjigje për rastet e regjistruara dhe veprimeve të ndërmarra me qëllim të rritjes së transparencës dhe ndjekjes së procedurave.

15 Platforma për mbrojtjen e gazetarëve të Këshillit të Evropës <https://www.coe.int/en/web/media-freedom/the-platform>

16 Doracak për sigurinë e gazetarëve gjatë ngjarjeve me rrezik të lartë (Breshkovski, Angelovski, Andonova) - nëntor 2018.

Fotografi 1



Fotografi 2



Legjislacioni në vend dhe praktika

Shqyrtim historik i ndryshimeve dhe plotësimeve të Kodit Penal në RMV

Neni 122 i Kodit Penal përcakton "gazetarin" si një person "i cili kryen funksione, detyra ose punë me interes publik ose të përgjithshëm" dhe "i cili kryen ato veprimtari në mënyrë të pavarur ose si një person juridik që kryen veprimtari me interes publik të caktuar me ligj", dhe me këtë gazetarët në një farë mënyre janë "diskriminuar pozitivisht" nga ligjvënësi, domethënë ata janë të përjashtuar nga përgjegjësia për krime të caktuara.

Ndryshimet e para pozitive në Kodin Penal që prekin gazetarët janë bërë me Ligjin për Ndryshimet në Kodin Penal ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 80/99 e datës 17.12.1999) ku shtohet përkufizimi i personave që kryejnë funksione, detyra ose punë me interes publik ose të përgjithshëm.

Kështu për shembull, në nenin 122, paragrafi 9, i cili siguron përkufizimet e shprehjeve në Kodin Penal, thuhet:

*„... (9) Një person i cili kryen veprimtari me interes publik konsiderohet të jetë një person që kryen funksione, detyra ose punë me interes publik ose të përgjithshëm, të tilla si një mësues, arsimtar, mjek, punonjës social, **gazetar**, noter, avokat ose person tjetër që kryen ato veprimtari në mënyrë të pavarur ose në një person juridik që kryen veprimtari në interes të publikut, pra interesit të përgjithshëm të përcaktuar me ligj...“*

Sipas nenit 122 paragrafi 9, me nenin 182-a nga Kodi Penal thuhet:

"Për veprat penale të neneve 178, 179, 181 dhe 182, përjashtohet përgjegjësia për gazetar në kryerjen e profesionin të gazetarisë, si dhe për personat e tjerë nëse mendimi i shprehur poshtëruet jepet në mbrojtje të lirisë së shprehjes publike të mendimit ose të drejtave të tjera ose mbrojtjen e interesit publik ose interesave të tjerë të justifikuar, ose me qëllim të sinqertë ose besim në mirëbesimin e mendimit të tij".

Kështu, me dispozitën e nenit 182-a të KP është bërë "diskriminimi pozitiv" ndaj gazetarëve. Gjegjesisht, ligjvënësi në aktet penale të deklaruara ka përjashtuar përgjegjësinë e gazetarëve për shprehjen e mendimeve poshtëruese kur ato

shprehen në mbrojtje të interesit publik. Këto janë veprat penale të parashikuara në kapitullin tetëmbëdhjetë të Kodit Penal, pra veprat penale kundër nderit dhe reputacionit.

Kështu, përgjegjësia penale e gazetarëve përjashtohet në nenin 178 - Shkelja e reputacionit të Republikës së Maqedonisë, neni 179 - Ekspozimi ndaj talljes së popullit maqedonas dhe anëtarëve të bashkësive, neni 181 - Shkelja e reputacionit të një shteti të huaj dhe neni 182 - Shkelja e reputacionit të organizatës ndërkombëtare, në rastet kur ata kanë shprehur një mendim poshtërues duke praktikuar profesionin e gazetarisë, në mbrojtjen e interesit publik, mbrojtjen e lirisë së shprehjes dhe arsye të tjera të justifikuara.

Shembull: lënda K-761/17 nga 31.05.2017

Duhet të theksohet këtu se kjo lëndë nuk është për "qytetarët e tjerë" dhe për këtë arsye ka edhe shembuj të tjerë nga praktika gjyqësore që janë miratuar vitet e fundit.

Gjegjësisht, Gjykata Themelore Penale Shkup në një procedurë të regjistruar nën K-761/17 nga 31.05.2017, duke vepruar pas një propozimi për lëshimin e urdhrit penal të Prokurorisë Publike - Shkup të regjistruar nën KO 1 nr. 800/16 nga 28.04.2017, për veprën penale - Shkelja e reputacionit të një shteti të huaj nga neni 181 i Kodit Penal, ka sjellë vendim për lëshimin e një urdhri penal në përputhje me nenin 499 të Ligjit për Procedurën Penale (LPK) me të cilin një person i cili është gjithashtu shtetas i Maqedonisë u gjobit me 24,600.00 denarë. Në këtë lëndë bëhet fjalë për tallje me Presidentit e Turqisë, Rexhep Taip Erdogan përmes një statusi në rrjetin social Facebook ku i pandehuri ka dëmtuar reputacionin e tij. Në vendim thuhet se në nëntor të vitit 2016, i pandehuri, përmes profilit të tij në rrjetin social, "publikoi deklarata ironike dhe ofendoi liderin e një vendi të huaj". Pyetja që shtrohet në atë rast është nëse gjykata ka zbatuar praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe nëse ka zbatuar në mënyrë korrekte paragrafin 2 të Nenit 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut? Kjo pyetje parashtrohet sepse në procedurën penale sanksioni penal kufizon të drejtën për lirinë e fjalës së një personi të caktuar.¹⁷

Dekriminalizimi i shpifjes dhe fyerjes

Ndryshimet dhe plotësimet në Kodin Penal që dekriminalizuan fyerjen dhe shpifjen janë një shembull pozitiv i mundësimit të ushtrimit publik të lirisë së shprehjes.

¹⁷ www.sud.mk

Gjegjësisht, me miratimin e Ligjit për ndryshimet në kodin penal të botuar në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë" Nr. 142, datë 13.11.2012, nenet 172, 173, 174, 175, 176, 177 fshihen dhe kështu fyerja dhe shpifja bëhen krime civile, të rregulluara me Ligjin për përgjegjësi civile për fyerje dhe shpifje ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", Nr. 143, datë 14.11.2012), në përputhje me nenin 25 paragrafët 1 dhe 2 të këtij ligji: *„... do të pezullohet nga ekzekutimi i gjobave ose kompensimit të dëmit për krimet e kryera nga Kapitulli tetëmbëdhjetë "Krimet kundër nderit dhe reputacionit" të Kodit Penal "*.

Gjatë përgatitjes së kësaj analize, lind nevoja për t'iu përgjigjur pyetjes: A janë gazetarët të "diskriminuar negativisht" ndaj dispozitave të Kodit Penal që parashikojnë sanksione dhe përgjegjësi për personat që kryejnë veprimtari me interes publik? Një kategori personash që përfshin edhe gazetarët sepse ata bëjnë punë që janë në interes të publikut.

Kështu: Lind pyetja: A duhet me dispozitën e nenit 273 paragrafi 6 i Kodit Penal, i cili sanksionon veprën penale "Pastrimi i parave dhe produkte të tjera të veprës penale" që parashikon burgim të paktën 5 vjet, nuk duhet të përfshijë edhe gazetarë, si persona që kryejnë veprimtari me interes publik. A është ky rasti edhe në dispozitat e nenit 353 paragrafi 4 i cili i referohet veprës penale "Shpërdorimi i pozitës dhe autoritetit zyrtar", domethënë nëse paragrafi 4 mund të interpretohet në mënyrë që të barazojë "zyrtarin" dhe një person "i cili kryen veprimtari me interes publik". E njëjta dilemë vlen për nenet e tjera të tilla si neni 354 "Mashtrimi në shërbimin" pastaj neni 357 "Marrja e rryshfetit" dhe neni 358 "Dhënia e rryshfetit".

Shuma e gjobave për personat që punojnë në interes të publikut nuk duhet të zbatohet edhe për gazetarët, duke qenë se mund të ketë një efekt negativ në punën e tyre, por edhe për shkak të faktit se natyra e profesionit të gazetarit është e ndryshme dhe ato nuk mund të janë të njëjta për gazetarët dhe për personat në pozitë zyrtare. Një argument shtesë pse gazetarët nuk mund të barazohen me zyrtarët për sa i përket gjobave më të mëdha është fakti që gazetarët nuk kanë fonde publike.

Definimi

Për të bërë ndonjë korrigjim në tekstin e Kodit Penal, duhet të merret parasysh termi "gazetar" ose përkufizimi i pranuar përgjithësisht i profesionit të gazetarisë. Kjo është e rëndësishme sepse nëse ekziston bëhet diskriminim pozitiv me disa ndryshime në KP, atëherë këtu duhet të përfshihen edhe personat që nuk janë "gazetarë tradicionalë", por merren me "marrjen dhe transmetimin" e informacionit tek publiku përmes kanaleve dhe platformave të ndryshme duke ndjekur inovacionet dhe trendët teknologjike. Për shkak se kjo është kështu, zhvillimi dhe përparimi në teknologji ka çuar në shfaqjen e mënyrave të reja të marrjes dhe transmetimit të informacionit, prandaj ndryshimet në KP janë shumë të nevojshme. Duhet të merren parasysh edhe ndryshime të tjera në drejtim të mbrojtjes së njerëzve të përfshirë në blogging, persona që përdorin vetëm rrjete sociale për të përcjellë pikëpamjet dhe informacionin e tyre, gazetarë të pavarur dhe fotoreporterë që përdorin kanale dhe teknologji të ndryshme për marrjen dhe transmetimin e informatave.

Për herë të parë në Republikën e Maqedonisë së Veriut, profesioni i gazetarit përcaktohet në nenin 2 pika 5 të Ligjit për Media ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 184, data 26.12.2013) i cili thotë:

".. Gazetari është një person i cili kryen aktivitete të mbledhjes, analizimit, përpunimit, formësimit dhe / ose klasifikimit të informatave që botohen në një medium dhe është i punësuar nga një botues i mediumit ose ka një kontratë me të njëjtin ose është një person që kryen veprimtari gazetareske si profesion i pavarur (gazetar i pavarur) .. "

Përkufizimi i përmbajtjes së termit gazetar mund të gjendet në organizatat ndërkombëtare. Kështu, sipas Federatës Ndërkombëtare të Gazetarëve (FNG):

Fjala "gazetar" përfshin persona që fitojnë pjesën më të madhe të të ardhurave të tyre nga mbledhja, përgatitja dhe shpërndarja e lajmeve, informatave të përgjithshme dhe komenteve, përmes të gjitha mjeteve të transmetimit, duke përfshirë mediat e shkruara, elektronike dhe audiovizuale. Filialet e FNG-së përfshijnë shkrimtarë, redaktorë, fotografë, kameramanë, artistë krijues, dizajnerë, staf nga studiot dhe njerëz që punojnë në ueb faqet e tyre."

Përkufizimi i një gazetari duhet të merret parasysh në kontekstin e të cilit personat me atë term do të përfshihen në Propozimin për ndryshime në KP. Ndryshimet me të cilat ata do të mbrohen në mënyrë të barabartë si zyrtarët, domethënë autorët e sulmeve që do t'i sulmojnë gazetarët, familjet e tyre dhe të drejtat e tyre të çdo

Iloji do të sanksionohen me sanksione të parashikuara si në rastet e sulmeve ndaj personave zyrtarëve, si një mënyrë për të parandaluar sulmet e mëtutjeshme. Nga ana tjetër, shtrohet pyetja nëse gazetarët, kur shfaqen si kryes të veprave penale për të cilat ndëshkohen zyrtarët, mund dhe duhet të barazohen në sanksione, pa shkelur parimin themelor kushtetues të barazisë së të gjithëve para ligjit?

Kjo pjesë e ligjeve, por edhe tema e përcaktimit ligjor të profesionit të gazetarit ose termi gazetar është e ndjeshme për arsye që, veçanërisht në këtë kontekst, nëse gazetarët barazohen me zyrtarët atëherë edhe ata do t'i nënshtrohen formave më të rënda të krimeve për të cilat përshkruhen më rëndë sanksionet penale. Për këto arsye, gazetarët nuk duhet të barazohen me zyrtarët, por duhet të ketë diskriminim pozitiv për shkak të punës specifike që bëjnë gazetarët në mënyrë që të gëzojnë një shkallë më të lartë të mbrojtjes ligjore nga institucionet.

Kjo do të thotë që konsideratat mbi këtë temë duhet të lëvizin në drejtim të ndryshimeve, në formën e plotësimit të KP-së me vepra penale të reja. Veprat penale që do të përmbajnë dispozita mbi bazën e të cilave për të sulmuar gazetarët punonjës mediatik ose persona që kryejnë profesionin e gazetarisë gjatë kryerjes së detyrave të tyre qoftë për persona të punësuar në media tradicionale apo "media online" ose ata e bëjnë atë në mënyrë të pavarur jashtë redaksisë, sanksioni do të jetë i njëjtë me sulmin ndaj zyrtarëve gjatë kryerjes së detyrave zyrtare.

Praktika e autoriteteve të prokurorisë

Është e rëndësishme të theksohet se në përputhje me praktikën aktuale për autoritetet e prokurorisë, doli që pasi akuzat penale paraqitën në Prokurorinë Publike nga një gazetar i dëmtuar, Prokuroria Publike e hedhë poshtë atë lëndë me shpjegimin se ishte një krim që nuk ndiqej sipas detyrës zyrtare duke dhënë këshillë ligjore për palën e dëmtuar për të ngritur një padi penale private.

Është fakt që në të gjitha këto raste gazetarët stimulohen të paraqesin padi private ose duke pritur vendimin pas përfundimit të akuzës, u kalon afati për ngritjen e një padie penale.

Sipas analizave të kryera nga SHGM, mos-paraqitja e padive penale private nga gazetarët e dëmtuar zakonisht ndodh për shkak të disa arsyeve. Frika e gazetarëve në procedurë për të deklaruar veten si paditës në vend të institucionit të Prokurorit Publik - kur ai do të ndiqte penalisht sipas detyrës zyrtare, frika e pasojave në shëndetin e tyre mendor dhe fizik nga kërcënimet dhe autorët e krimeve me të

cilët si paditës gjatë gjithë procedurës duhet të përballen, ndërsa këtu është edhe aspekti financiar i kryerjes së procedurës.

Gjegjësisht, është fakt që nëse për ato vepra penale ndjekja do të ndërmerrej sipas detyrës zyrtare nga Prokurori Publik, si përfaqësues i palës së dëmtuar, shpenzimet e shkaktuara gjatë zhvillimit të procedurës nuk do të barten nga pala e dëmtuar. Përndryshe, kur procedura kryhet pas një procesi gjyqësor privat nga pala e dëmtuar, ata bien mbi të deri në vendimin e gjykatës se kush do të jetë i detyruar t'i paguajë ato shpenzime. Meqenëse kryerja e procedurës nga pikëpamja profesionale nuk është e thjeshtë, nevoja për të punësuar një avokat si përfaqësues është e nevojshme, e cila lidhet me kostot e ndihmës juridike. Gjithashtu kostot që nuk janë të papërfillshme në procedurë duhet t'i bartë paditësi si palë e dëmtuar.

Arsyet e deklaruara për mos ngritjen e padive private nga gazetarët e dëmtuar theksohen veçanërisht në rastet kur janë kryer krime nga neni 144 - Rrezikimi i sigurisë, nga Kodit Penal, pavarësisht nëse ka ndodhur në internet (kërcënime përmes internetit, rrjeteve sociale, mesazhe përmes aplikacioneve të ndryshme për komunikime përmes internetit etj.) ose përderisa gazetarët kryenin punë në terren, raportonin për një ngjarje ose bënë gazetari hulumtuese.

SHGM përmes monitorimit të rregullt të sulmeve ndaj gazetarëve dhe veprimeve të ndërmarra nga organet e zbatimit të ligjit ka vërejtur praktika të ndryshme në lidhje me këto çështje. Kështu, në raste të caktuara të kërcënimeve ndaj gazetarëve përmes internetit, ka shembuj kur Prokuroria Themelore Publike vendos të veprojë sipas detyrës zyrtare, domethënë të hapë një hetim ose të ngrëjë aktakuzë, dhe në raste të tjera i referohet paragrafit 5 të nenit 144 të KP.

Me kësi lloj të aplikimit të praktikës për gazetarët krijohet një i ashtuquajtur "efekt ftohës"(chilling effect). Në kontekstin ligjor, ky term nënkupton dekurajim të së drejtës legjitime të gazetarëve por edhe të çdo qytetari për të ushtruar të drejtat e tyre themelore para institucioneve, domethënë heqje dorë nga e drejta për të kërkuar mbrojtje institucionale, heqje dorë nga frika e pasojave për jetën, shëndetin fizik dhe mendor, nderin, reputacionin, dinjitetin, emrin personal, privatësinë e jetës personale dhe familjare, lirinë etj. (Neni 9-a, Ligji mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve të RMV).

Problemi paraqitet kur gazetarët për të drejtën e tyre të kompensimit janë të detyruar të kërkojnë drejtësi në procedurë civile duke ngritur padi për dëmshpërblim kundër sulmuesve të dënuar. Vetë fakti që gazetari duhet të përballë me sulmuesin

në sallën e gjyqit paraqet një stres dhe sfidë e madhe, dhe në procedurat për kompensimin e dëmit jopasuror për shkeljen e të drejtave personale, marrja në pyetje e paditësit të dëmtuar, sulmuesit të pandehur ose dëgjimit të dëshmitarëve është thelbësore. Përveç kësaj, këto procedura shkaktojnë shpenzime të larta për gazetarët e dëmtuar siç janë ekzaminimet mjekësore, tarifat juridike, tarifat gjyqësore, etj. Hapi i parë për gazetarët e dëmtuar është të paraqesin një kërkesë për dëm material ose jo material në vetë procedurën e kundërvajtjes ose në procedurën penale. Në ato procedura, gjykata jep kompensim për dëmin material dhe do t'i detyrohet të pandehurit (për shembull, një aparat fotografik i dëmtuar ose pronë tjetër personale), por për kompensimin e dëmit jopasuror, gjykata do të udhëzojë palët e dëmtuara të ushtrojnë atë të drejtë në procedurat civile.

Kjo është edhe një arsye tjetër që ligjvënësi të bëjë dallimin në Kodin Penal midis krimeve të kryera kundër një gazetari dhe krimeve kundër një personi që nuk është gazetar ose një personi të afërt me të. Standardi për të pranuar këtë është motivi dhe qëllimi i autorit të krimit, duke pasur parasysh që motivet e autorëve të krimeve kundër gazetarëve janë specifike si bazë për marrjen e vendimit për të sulmuar një gazetar.

Gjegjësisht, qëllimi kryesor për sulmim dhe dhunë ndaj një gazetari është që ai të hesht, të parandalohet mbledhja e informatave për një rast të caktuar, ose të parandalohet që ndonjë informatë të arrijë në publik. Sipas nenit 16 paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë së veriut "Liria e qasjes së lirë në informata, liria e marrjes dhe transmetimit të informatave është e garantuar". Kjo është fakti i mjaftueshëm për të cilin ia vlen të kërkoen ndryshime në KP që do të mundësojë mbrojtje më të madhe të gazetarëve dhe në veçanti për gazetarinë hulumtuese.

Përfundime dhe rekomandime

Analiza e sulmeve ndaj gazetarëve dhe punonjësve mediatik në periudhën janar 2018 deri në vitin 2020 të renditura në raportin "Rastet e shkeljes së të drejtave të gazetarëve - shtator 2020"¹⁸ të përgatitur nga SHGM, konfirmon se një përqindje e madhe e sulmeve ndaj gazetarëve janë kërcënime në formë të shkruar ose me gojë, kryesisht përmes internetit, dhe pjesërisht si kërcënime verbale të drejtpërdrejta ndaj gazetarëve që kryenin detyrat e tyre të punës në terren. Duhet të theksohet se në periudhën e përmendur, një nga kërcënuesit është anëtar i një partie politike dhe ish-kryetar i një komune të Shkupit, një tjetër është ish-anëtar i një partie politike, ndërsa midis personave të tjerë që kërcënuan gazetarët janë biznesmenë të njohur, të afërm të zyrtarëve të lartë nga partitë në pushtet, kryetarë të komunave, politikanë dhe të tjerë.

Prandaj, përfundimi është se një nga zgjidhjet për të parandaluar sulmet ndaj gazetarëve dhe punonjësve mediatik, në ushtrimin e të drejtave të tyre përmes institucioneve është ndryshimi i Kodit Penal në pjesën e dispozitave në seksionin e veçantë dhe ndryshimet në Ligjin e Procedurës Penale. Këto ndryshime duhet t'i japin autoritet më të madh Prokurorisë Themelore Publike për të vepruar sipas detyrës zyrtare kur shkelen të drejtat e gazetarëve, por edhe për të rritur dënimet për sulmimin e gazetarëve.

Si shembull mund të merret vepra penale "Vrasja" neni 123 pika 8 e paragrafit 2 të KP. Mund të shihet se gazetarët, edhe pse sipas nenit 122 të KP janë persona që kryejnë veprimtari me interes publik, nuk kanë të njëjtën shkallë të mbrojtjes si gjyqtarët, prokurorët publik ose avokatët në kryerjen e funksioneve të tyre dhe të cilët mbrohen nga një formë më e ashpër - e kualifikuar për atë krim. Ndërhyrja në atë dispozitë do të ishte në një mënyrë që të shtonte fjalën gazetar ose një person që kryen profesionin e gazetarisë. Ky ndryshim i kësaj dispozite do të rrisë ndjeshëm nivelin e mbrojtjes së gazetarëve.

Dy shembuj të tjerë që meritojnë të nënvizohen si vepra penale aty ku është e mundur dhe duhet të ndryshohen, si në veprën penale "Vrasja" janë dispozitat e nenit 382 - "Parandalimi i një zyrtari nga kryerja e një veprimi zyrtar" dhe neni 384 i Kodit Penal - "Pjesëmarrja në turmë që do të parandalojë një zyrtar të kryejë veprimin zyrtar", sipas të cilëve:

18 Rastet e shkeljes së të drejtave të gazetarëve - shtator 2020 <https://znm.org.mk/izveshtai/>

Neni 382

„... (1) Një person i cili me forcë ose kërcënim serioz se do të sulmojë drejtpërdrejt jetën ose trupin do të parandalojë një person zyrtar nga kryerja e një veprimi zyrtar ose do ta detyrojë atë të kryejë një veprim zyrtar, do të dënohet me gjobë, ose me burgim deri në tre vjet.

(2) Nëse gjatë kryerjes së veprës penale nga pika 1 kryesi ka fyer ose ngacmuar zyrtarin ose ka shkaktuar lëndime trupore ose është kërcënuar se do të përdorë armë, ai do të dënohet me burgim nga tre muaj deri në tre vjet.

(3) Një person i cili kryen krimin nga paragrafët 1 dhe 2 ndaj një zyrtari ose një person i cili ndihmon në kryerjen e veprimtarive të sigurisë publike ose mbrojtjen e rendit kushtetues të Republikës së Maqedonisë në lidhje me parandalimin ose zbulimin e një krimi, kapjen e autorit të një krimi, mbajtja e rendit publik ose mbajtja e një personi të privuar nga liria dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në pesë vjet.

(4) Përpjekja për të bërë shkelje e përshkruar në paragrafët 1 dhe 2 do të dënohet.

(5) Nëse kryesi i krimit nga pikat 1, 2 dhe 3 është stimuluar nga veprimi i paligjshëm ose i vrazhdë i zyrtarit ose personit që ndihmon, ai mund të lirohet nga dënimi ...”

Neni 384

„... (1) Një person që merr pjesë në turmë që me veprim të përbashkët do të parandalojë ose do të përpiqet të parandalojë një person zyrtar nga kryerja e veprimit zyrtar ose në të njëjtën mënyrë do ta detyrojë atë që të kryejë një veprim zyrtar, dënohet me burgim nga tre muaj deri në tre vjet.

(2) Lideri i turmës do të dënohet me një deri në pesë vjet burg...”

Fakti që në të kaluarën kishte shumë raste kur gazetarët ishin viktimë përderisa raportonin për ngjarje me rrezik të lartë (protesta, tubime, ndeshje sportive, trazira, etj.), Ku ata sulmoheshin nga pjesëmarrësit në ngjarje, por edhe raste kur të drejtat e tyre kërcënoheshin nga anëtarët e policisë ose të sigurisë së një institucioni të veçantë nga i cili raportuan (të detajuar në një botim të veçantë për sigurinë e gazetarëve gjatë ngjarjeve me rrezik të lartë të lëshuar nga SHGM në nëntor 2018¹⁹),

19 <https://znm.org.mk/wp-content/uploads/2020/07/priracnik-za-bezbednost.pdf> (OSBE, SHGM, MPB)

gjithashtu konfirmon nevojën për ndryshimet e deklaruara në KP.

Me këtë do të përmbushen rekomandimet e Këshillit të Evropës të konfirmuara nga praktika gjyqësore e Gjykatës së Strasburgut.

Gjegjësisht, në lëndën Selmani dhe të tjerët kundër RMV, gjykata është e mendimit se largimi i gazetarëve nga Kuvendi në ditën kritike është një shkelje e drejtpërdrejtë e nenit 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut sepse publiku është i privuar nga "informatat e dorës së parë" që do t'i merrnin nga gazetarët. Sipas mendimit të tij, çdo ndërhyrje në punën e gazetarëve, fotoreporterëve, kameramanëve dhe punonjësve të tjerë mediatik që raportojnë ose ndjekin ngjarje kritike me rëndësi të madhe për publikun duhet të sanksionohet ashpër. Sidomos ashpër nëse kryhet me përdorimin e forcës nga zyrtarët.

Duhet theksuar se është absolutisht e nevojshme që gazetarëve t'u sigurohet një mbrojtje më e madhe ligjore gjatë kryerjes së detyrave të tyre, posaçërisht duke raportuar nga terreni ku rreziku për t'i sulmuar dikush është i lartë, në mënyrë që veprimet që ata kryejnë të trajtohen si veprimet zyrtare për parandalimin e të cilave do të vendoset një sanksion më i rreptë ndaj sulmuesve.

Ndërhyrje e cila përmes ndryshimit të Kodit Penal është e mundur dhe e domosdoshme në nenin 139 "Detyrimi", neni 130 "Lëndimi fizik", neni 131 "Lëndimi i rëndë trupor" si dhe neni 144 "Rrezikimi i sigurisë".

Fakti që sulmet ndaj gazetarëve përmes internetit, qofshin ato në rrjetet sociale, aplikacione të ndryshme komunikimi dhe platforma të tjera janë të shpeshta dhe tashmë po përhapen gjithnjë e më shumë, imponon nevojën për të ndryshuar dispozitën e nenit 394-g të KP-së "Përhapja e racizmit dhe materialit ksenofob përmes sistemit kompjuterik "i cili thotë:

(1) Një person i cili, përmes sistemit kompjuterik, shpërndan material të shkruar racist dhe ksenofob, fotografi ose përfaqësime të tjera të një ideje ose teorie që ndihmon, promovon ose nxit urrejtje, diskriminim ose dhunë ndaj çdo personi ose grupi, bazuar në gjini, racë, ngjyra e lëkurës, gjinia, grupi i marginalizuar, përkatësia etnike, gjuha, kombësia, origjina shoqërore, feja apo besimi, lloje të tjera të besimeve, edukimi, përkatësia politike, statusi personal ose shoqëror, paaftësia mendore ose fizike, mosha, statusi martesor, statusi pasuror, gjendja shëndetësore, ose për çfarëdo arsye tjetër të parashikuar me ligj ose një marrëveshje ndërkombëtare të ratifikuar, do të dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet.

(2) Me dënimin nga paragrafi (1) të këtij neni do të dënohet edhe ai që kryen veprën penale përmes mjeteve të tjera të informimit publik.

(3) Personi i cili kryen veprën penale nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni duke keqpërdorur pozitën ose autorizimin e tij ose nëse për shkak të atyre veprimeve ka pasur çrregullim dhe dhunë ndaj njerëzve ose dëmtim të madh pasuror, do të dënohet me burgim prej një deri në dhjetë vjet. Gjegjesisht, gjetjet e deritanishme konfirmojnë se Sektori për Krimin Kompjuterik dhe Forensikën Digjitale në Ministrinë e Punëve të Brendshme ka ngritur disa akuza penale në Prokurorinë Themelore Publike për shkak të dyshimit të arsyeshëm për krime të dënueshme sipas Nenit 394-g të Kodit Penal. I ka paraqitur ato sepse rrjetet sociale përdoren shpesh nga sulmuesit për të nxitur urrejtje, dhunë dhe diskriminim ndaj grave gazetare si një kategori më e ndjeshme. Fakti që deri më tani efekti i paraqitjes së tyre nuk manifestohet me zvogëlimin e numrit të tyre, por jemi dëshmitarë se ato janë intensifikuar dhe ka gjithnjë e më shumë prej tyre, konfirmon se ndryshimi i kësaj dispozite, në drejtim të mbrojtjes së shtuar të gazetarëve me dënime më të ashpra është i domosdoshëm. Disa nga këto kërkesa nga Ministria e Punëve të Brendshme drejtuar Prokurorisë Publike u iniciuan nga SHGM në emër të gazetarëve të dëmtuar. Përveç kësaj, në disa raste SHGM në arkivat e saj regjistron kërkesa të drejtpërdrejta për veprim nga Prokuroria Publike për të njëjtat akte të parashikuara në këtë nen të KP-së.

Nevoja për ndryshime në Kodin Penal është e dokumentuar nga gazetarët në formë të shkruar në publikimin me "Analiza dhe rekomandimet për ndryshimet në Kodin Penal të Republikës së Maqedonisë për rritjen e mbrojtjes së ekipeve gazetareske në kryerjen e detyrës së tyre profesionale",²⁰ Një dokument i lëshuar nga Sindikata e Pavarur e Gazetarëve dhe Punonjësve Mediatik (SPGPM) më 16 nëntor të vitit 2017 dhe një dokument i cili, pas një analize krahasuese të këtyre problemeve në disa vende të rajonit, Evropës Lindore dhe Azisë, thotë:

"Duke pasur parasysh sulmet e shpeshhta ndaj gazetarëve në Maqedoni dhe për të siguruar mbrojtje të përmirësuar ligjore, SPGPM beson se futja e krimeve të reja në Kodin Penal "Parandalimi i gazetarëve në kryerjen e detyrave profesionale" dhe "Sulmi mbi gazetarët gjatë kryerjes së detyrave profesionale" ose plotësimi i akteve ekzistuese kriminale të "Vrasjes së rëndë" dhe "Dëmtimit të rëndë trupor" mund të kontribuojë në parandalimin e autorëve të mundshëm të sulmeve të tilla në të ardhmen".

20 Analiza dhe rekomandimet për ndryshimet në Kodin Penal të Republikës së Maqedonisë për rritjen e mbrojtjes së ekipeve gazetareske në kryerjen e detyrës së tyre profesionale – SPGPM <https://ssnm.org.mk/wp-content/uploads/2017/11/%D0%90%D0%BD%D0%B0%D0%BB%D0%B8%D0%B7%D0%B0-%D0%B8-%D0%BF%D1%80%D0%B5%D0%BF%D0%BE%D1%80%D0%B0%D0%BA%D0%B8-%D0%B7%D0%B0-%D0%9A%D0%97-FINAL.pdf> nga nëntori, viti 2017.

Përfundimi i fundit është:

Është thelbësore - dhe është koha e fundit për të ndryshuar Kodin Penal dhe Ligjin e Procedurës Penale në mënyrë që:

1. T'i mundësohet Prokurorit Publik të veprojë sipas detyrës zyrtare pas të gjitha sulmeve të identifikuara dhe të dokumentuara ndaj gazetarëve dhe punonjësve mediatik, familjeve të tyre dhe të drejtave të tyre të çdo lloji, të kryera gjatë kryerjes së detyrave të tyre në formën e sulmeve fizike, kërcënimeve dhe ngacmimeve që bëhen gjatë punës në terren, përmes mediave, por edhe përmes të gjitha platformave të internetit, rrjeteve sociale ose çdo lloj komunikimi elektronik.

2. Për autorët e krimeve kundër gazetarëve dhe punonjësve mediatik, familjeve të tyre dhe të drejtave të çdo lloji të kryera gjatë kryerjes dhe për shkak të kryerjes së detyrave të tyre profesionale, të vendosin dënime më të rrepta që do të sigurojnë që jo vetëm gazetarët dhe familjet e tyre do të ndihen më të mbrojtur, por edhe do të forcohet parandalimi individual dhe i përgjithshëm.

ISBN 978-608-4648-56-7